



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.166

7 dhjetor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 180 datë 29.10.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për të drejtën e patentave të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO)	7317
Ligj nr.10 181 datë 29.10.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar, 2002”	7332
Ligj nr.10 182 datë 29.10.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e Konferencës së Hagës “Për procedurën civile”	7334
Ligj nr.10 183 datë 29.10.2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”	7342
Ligj nr.10 184 datë 29.10.2009	Për faljen e kamatëvonesave të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, të papaguara, të të vetëpunësuarve në bujqësi	7345
Ligj nr.10 187 datë 12.11.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes për thjeshtimin e procedurave të vizave për shoferët profesionistë të kamionëve, shtetas të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi”	7346
Ligj nr.10 188 datë 12.11.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes për thjeshtimin e procedurave të vizave për afaristët, shtetas të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi”	7350
Ligj nr.10 189 datë 12.11.2009	Për ratifikimin e “Protokollit për imunitetet dhe privilegjet e Asamblesë Parlamentare të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi”	7353

LIGJ
Nr.10 180, datë 29.10.2009

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN PËR TË
DREJTËN E PATENTAVE TË ORGANIZATËS BOTËRORE TË PRONËSISË
INTELEKTUALE (WIPO)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen për të drejtën e patentave të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelaktuale (WIPO), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6339, datë 17.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJA E LIGJIT MBI PATENTAT
(Miratuar në Gjenevë më 1 qershor 2000)

Neni 1

Shprehjet e shkurtuara

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, nëse nuk deklarohet shprehimisht ndryshe:

i) “Zyrë” është autoriteti i një pale kontraktuese që siguron dhënien e patentave ose që përfshin çështje të tjera që trajton kjo Marrëveshje.

ii) “Aplikimi” është kërkesa për dhënien e një patente, siç parashikohet në nenin 3.

iii) “Patentë” është patenta e parashikuar në nenin 3.

iv) Referencat tek një “Person” do të konsiderohen se përfshijnë në mënyrë të veçantë një person fizik dhe një person juridik.

v) “Komunikim” është çdo aplikim ose çdo kërkesë, deklaratë, dokument, korrespondencë ose informacion tjetër i lidhur me një aplikim ose patentë, pavarësisht nëse lidhet me procedurën në përputhje me këtë Marrëveshjeje ose jo, e cila depozitohet në Zyra.

vi) “Regjistrat e Zyrës” janë përmbledhjet e informacioneve që administrohen nga Zyra, në lidhje me dhe duke përfshirë aplikimet e depozituara dhe patentat e dhëna nga Zyra ose nga një autoritet tjetër që ka fuqi për palët kontraktuese përkatëse, pavarësisht nga mënyra në të cilin mbahet ky informacion.

vii) “Regjistrim” është çdo veprim që reflekton informacionin në regjistrat e Zyrës.

viii) “Aplikant” është personi që figuron në regjistrat e Zyrës, në përputhje me ligjin në fuqi, si personi që depoziton ose ndjek aplikimin për patentë.

ix) “Pronar” është personi që në regjistrat e Zyrës figuron si pronar i patentës.

- x) “Përfaqësues” është një përfaqësues në përputhje me ligjin në fuqi.
- xi) “Nënshkrim” është çdo mjet i vetidentifikimit.
- xii) “Një gjuhë e pranuar nga Zyra” është njëra prej gjuhëve të pranura për ndjekjen e procedurave përkatëse pranë Zyrës.
- xiii) “Përkthim” është përkthimi në një gjuhë ose, sipas rastit, përshtatja në një alfabet ose komplet karakteresh, të pranuar nga Zyra.
- xiv) “Procedurë pranë Zyrës” është çdo lloj procedure e cila depozitohet para Zyrës në lidhje me një aplikim ose patentë.
- xv) Me përjashtim të rastit kur konteksti tregon ndryshe, fjalët në njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, dhe përemrat vetorë mashkullorë përfshijnë edhe ato femërorë.
- xvi) “Konventa e Parisit” është Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale, e nënshkruar më 20 mars 1883, e rishikuar dhe ndryshuar.
- xvii) “Marrëveshja e bashkëpunimit për patentat” është Marrëveshja e Bashkëpunimit për Patentat, e nënshkruar më 19 qershor 1970, së bashku me rregulloret dhe udhëzimet administrative sipas kësaj Marrëveshjeje, të rishikuar, ndryshuar dhe modifikuar.
- xviii) “Palë Kontraktuese” është çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare që është palë në këtë Marrëveshje.
- xix) “Ligj në fuqi” është, kur Pala Kontraktuese është një shtet, ligji i atij shteti dhe, nëse Pala Kontraktuese është një organizatë ndërqeveritare, aktet ligjore në të cilat operon ajo organizatë ndërqeveritare.
- xx) “Instrument ratifikimi” përfshin instrumentet e pranimi ose miratimit.
- xxi) “Organizatë” është Organizata Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale.
- xxii) “Zyrë ndërkombëtare” është Zyra Ndërkombëtare e Organizatës.
- xxiii) “Drejtor i përgjithshëm” është Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës.

Neni 2

Parime të përgjithshme

1) [Kërkesat më të favorshme]. Një Palë Kontraktuese është e lirë të parashikojë kërkesat që, nga këndvështrimi i aplikantit ose pronarit, janë më të favorshme se kërkesat e parashikuara në këtë Marrëveshje dhe rregullore, të ndryshme nga neni 5.

2) [Mosrregullimi i ligjit material për patentat]. Asgjë në këtë Marrëveshje ose rregullore nuk ka për qëllim të parashikojë diçka që do të kufizonte lirinë e një shteti kontraktues për të parashikuar kërkesa të ligjit material të zbatueshëm për patentat sipas mënyrës së tij.

Neni 3

Aplikimet dhe patentat tek të cilat zbatohet Marrëveshja

1) [Aplikimet]. (a) Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe rregulloreje do të zbatohen për aplikimet kombëtare dhe aplikimet rajonale për patentat për shpikjet dhe për patentat shtesë të cilat depozitohen tek ose për Zyrën e një Pale Kontraktuese dhe të cilat janë:

i) tipet e aplikimeve që mund të depozitohen si kërkesa ndërkombëtare në përputhje me Marrëveshjen e bashkëpunimit për patentat;

ii) aplikime të ndara të tipeve të kërkesave të cilave i referohet pika (i), për patentat për shpikjet ose për patentat shtesë, që i referohet neni 4G(1) ose (2) të Konventës së Parisit.

b) Objekti i dispozitave të Marrëveshjes së bashkëpunimit për patentat, parashikuar në këtë Marrëveshjeje dhe rregulloret zbatohen për aplikimet ndërkombëtare, për patentat e shpikjes dhe për patentat shtesë, sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit për patentat:

i) në lidhje me afatet kohore të zbatueshme sipas neneve 22 dhe 39(1) të Marrëveshjes së bashkëpunimit për patentat në Zyrën e një Pale Kontraktuese;

ii) në lidhje me çdo procedurë të filluar në ose pas datës në të cilën mund të fillojë procesi ose ekzaminimi i një aplikimi ndërkombëtar sipas nenit 23 ose 40 të kësaj Marrëveshjeje.

2) [Patentat]. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe rregulloreje zbatohen për patentë kombëtare dhe rajonale të shpikjeve dhe për patentat kombëtare dhe rajonale shtesë, që janë të ripërtërira nga një Palë Kontraktuese.

Neni 4

Përjashtimi për shkak të sigurisë kombëtare

Asgjë në këtë Marrëveshje dhe rregullore nuk do të kufizojë lirinë e një Pale Kontraktuese për të ndërmarrë çdo veprim që e konsideron të nevojshëm për ruajtjen e interesave të larta të sigurisë.

Neni 5

Data e depozitimit

1) [Elementet e aplikimit]

a) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në rregullore, përkatësisht në pikat (2) deri (8), një Palë Kontraktuese duhet të parashikojë që data e depozitimit të një kërkesë të jetë data në të cilën Zyra ka marrë në dorëzim të gjitha elementet e mëposhtme, të depozituara, sipas zgjedhjes së aplikantit, në formë të shkruar ose në formën që ka parashikuar Zyra, me qëllim njohjen e datës së depozitimit:

i) një përshkrim të detajuar për të shprehur qëllimin, si dhe elementet që përbëjnë një aplikim;

ii) një përshkrim të detajuar që të mundësohet vërtetimi i identitetit të aplikantit ose të mundësohet kontaktimi i aplikantit nga Zyra;

iii) një pjesë e të cilit në vështirësi të parë është përshkrimi.

b) Një Palë Kontraktuese mund, për qëllimin e njohjes së datës së depozitimit, të pranojë një skicë si element i referuar në nënpikën (a)(iii).

c) Për qëllimin e njohjes të datës së depozitimit, një Palë Kontraktuese mund të kërkojë informacion në të njëjtën kohë për vërtetimin e identitetit të aplikantit, si dhe informacion që mundëson kontaktimin e aplikantit nga Zyra, ose mund të pranojë dokumente që mundësojnë vërtetimin e identitetit të aplikantit ose që mundësojnë që aplikanti të kontaktohet nga Zyra, si element që referohet në nënpikat (a)(ii).

2) [Gjuha] (a) Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë që elementet e përmendura në pikën (1)(a)(i) dhe (ii) të jenë në gjuhën e pranuar nga Zyra.

b) Pjesët që referohen në pikën (1)(a)(iii), me qëllimin e datës së depozitimit, mund të depozitohen në çdo gjuhë.

3) [Njoftimi]. Nëse aplikanti nuk përmbush një ose disa nga kërkesat e parashikuara nga Pala Kontraktuese sipas pikave (1) dhe (2), Zyra do të njoftojë aplikantin sa më parë të jetë e mundur duke i dhënë mundësinë të përmbushë kërkesat e parashikuara, si dhe të bëjë vërejtjet, brenda afatit kohor të parashikuar në Rregullore.

4) [Përmbushja e mëtejshme e kërkesave]

a) Nëse një ose disa nga kërkesat e parashikuara nga Pala Kontraktuese, në përputhje me pikat (1) dhe (2) nuk depozitohen së bashku me aplikimin fillestar, data e depozitimit, në përputhje me nënpikën (b) dhe pikën (6), do të jetë data në të cilën përmbushen të gjitha kërkesat e parashikuara nga Pala Kontraktuese sipas pikave (1) dhe (2).

b) Një Palë Kontraktuese mund të parashikojë që, nëse një ose disa nga kërkesat e lartpërmendura në nënpikën (a) nuk do të përmbushen brenda afatit kohor të parashikuar në rregullore, aplikimi do të konsiderohet si i padepozituar. Nëse aplikimi do të konsiderohet i padepozituar, Zyra njofton aplikantin sipas rregullave, duke treguar për këtë arsye përkatëse.

5) [Njoftimi në lidhje me pjesën që mungon të përshkruar ose skicimit]. Nëse në përcaktimin e datës së depozitimit, Zyra konstaton që një pjesë e përshkrimit duket sikur mungon në aplikim, ose aplikimi i referohet një skicimi që duket se mungon në këtë aplikim Zyra njofton

menjëherë aplikantin sipas rregullave.

6) [Data e depozitimit kur depozitohet pjesa që mungonte e përshkrimit ose skicimit]

a) Nëse pjesa që mungon e përshkrimit ose e skicimit depozitohet në Zyrë brenda afatit kohor të parashikuar në rregullore, ajo pjesë e përshkrimit ose skicimit do të përfshihet në aplikim, dhe, në përputhje me nënpikat (b) dhe (c), data e depozitimit do të jetë data në të cilën është depozituar në Zyrë ajo pjesë e përshkrimit ose e skicimit, ose data në të cilën do të përmbushen të gjitha kërkesat e parashikuara nga Pala Kontraktuese në përputhje me pikat (1) dhe (2), pavarësisht vonësës.

b) Nëse një pjesë e përshkrimit ose e skicimit që mungon depozitohet sipas nënpikës (a) me qëllim korrigjimin e aplikimit fillestar që nga data në të cilën një ose disa elemente të lartpërmendura në pikën (1)(a) janë depozituar më parë në Zyrë, pretendohet për prioritet të një kërkesë të mëparshme, data e depozitimit, me kërkesën e aplikantit duhet të depozitohet brenda afatit kohor të parashikuar në rregullore, si dhe në përputhje me kërkesat e parashikuara në rregullore, do të jetë data në të cilën do të përmbushen kërkesat e parashikuara nga Pala Kontraktuese sipas pikave (1) dhe (2).

c) Nëse një pjesë e përshkrimit ose e skicimit që mungon i depozituar në përputhje me nënpikën (a) tërhiqet brenda një afati kohor të përcaktuar nga Pala Kontraktuese, data e depozitimit do të jetë data në të cilën përmbushen kërkesat e parashikuara nga Pala Kontraktuese në përputhje me pikat (1) dhe (2).

7) [Zëvendësimi i përshkrimit dhe skicimeve duke iu referuar një aplikimi të mëparshëm]

a) Në përputhje me kërkesat e parashikuara në rregullore, duke iu referuar një aplikimi të mëparshëm, në një gjuhë të pranuar nga Zyra, tek një kërkesë e depozituar më parë, për qëllimet e datës së depozitimit të kërkesës, zëvendëson përshkrimin dhe çdo skicim.

b) Nëse kërkesat e lartpërmendura në nënpikën (a) nuk përmbushen, aplikimi mund të konsiderohet i padepozituar. Nëse aplikimi konsiderohet i padepozituar, Zyra njofton aplikantin sipas rregullave, duke treguar për këtë arsye përkatëse.

8) [Përjashtimet]. Asgjë në këtë nen nuk do të kufizojë:

i) të drejtën e një aplikanti sipas nenit 4G (1) ose (2) të Konventës së Parisit për të gëzuar të drejtën, si datë të aplikimit të ndarë referuar në këtë nen, datën e aplikimit fillestar duke iu referuar këtij neni, si dhe përfitojë të drejtën e prioritetit, në rast se ka;

ii) lirinë e një Pale Kontraktuese që të zbatojë çdo kërkesë të nevojshme për dhënien dhe përfitimin e datës së depozitimit të një aplikimi të mëparshëm, ndaj një aplikimi ose çdo lloj kërkesë të parashikuar në rregullore.

Neni 6 Aplikimi

1) [Forma ose përmbajtja e aplikimit]. Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, asnjë Palë Kontraktuese nuk do të kërkojë përmbushjen e ndonjë kërkesë tjetër në lidhje me formën ose përmbajtjen e aplikimit të ndryshme ose përveç:

i) kërkesave në lidhje me formën ose përmbajtjen që janë parashikuar në lidhje me aplikimet ndërkombëtare në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit për patentat;

ii) kërkesave në lidhje me formën ose përmbajtjen, respektimi i të cilave, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit për patentat, mund të kërkojen nga Zyra, ose që vepron si një shtet palë në atë Marrëveshje, me fillimin e procesit të ekzaminimit të një aplikimi ndërkombëtar të parashikuar në nenin 23 ose 40 të kësaj Marrëveshjeje;

iii) çdo kërkesë tjetër të parashikuar në rregullore.

2) [Formulari i aplikimit]

a) Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë që përmbajtja e një aplikimi në raport me përmbajtjen e një aplikimi ndërkombëtar sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit për patentat të paraqitet në një formular aplikimi të parashikuar nga ajo Palë Kontraktuese. Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë që në formularin e aplikimit të përfshihen kërkesat në përputhje me pikën (1)(ii)

ose në përputhje me rregulloren sipas pikës (1)(iii).

b) Pavarësisht nënpikës (a) dhe në përputhje me nenin 8(1), një Palë Kontraktuese do të pranojë përmbajtjen e lartpërmendur duke iu referuar nënparagrafit (a) në një formular aplikimi të parashikuar në rregullore.

3) [Përkthimi]. Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë përkthimin e çdo pjese të aplikimit që nuk është në një gjuhë të pranuar nga Zyra e saj. Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë gjithashtu një përkthim të pjesëve të aplikimit, në përputhje me rregulloren, të cilat janë në gjuhën e pranuar nga Zyra ose në çdo gjuhë tjetër të pranuar nga Zyra.

4) [Tarifat]. Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë që në lidhje me një aplikim të paguhet tarifa. Pala Kontraktuese mund të zbatojë dispozitat e Marrëveshjes së bashkëpunimit për patentat në lidhje me pagesën e tarifave të aplikimit.

5) [Dokumenti i prioritetit]. Nëse pretendohet për prioritetin e një aplikimi më të hershëm, një Palë Kontraktuese mund të kërkojë kopjen e aplikimit të mëparshëm, si dhe përkthimin e aplikimit të mëparshëm nëse nuk është në gjuhën e pranuar nga Zyra, të depozitohet në përputhje me kërkesat e parashikuara në rregullore.

6) [Prova]. Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë që provat në lidhje me ndonjë çështje të përmendur në paragrafin (1) ose (2) ose për deklaratën për prioritet ose përkthimin e lartpërmendur në paragrafin (3) ose (5), të depozitohen pranë Zyrës së saj gjatë procedimit të aplikimit vetëm në rastin kur Zyra dyshon në lidhje me vërtetësinë e një çështjeje ose saktësinë e përkthimit.

7) [Njoftimi]. Nëse një ose më shumë kërkesa që aplikohen nga Pala Kontraktuese në përputhje me paragrafët (1) deri në (6) nuk përmbushen, Zyra njofton aplikantin duke i dhënë mundësinë të përmbushë këto kërkesa dhe të depozitojë vërejtjet brenda afatit kohor të parashikuar në rregullore.

8) [Mospajtueshmëria me kërkesat]

a) Nëse një ose më shumë kërkesa që aplikohen nga Pala Kontraktuese në përputhje me paragrafët (1) deri në (6) nuk janë në përputhje me afatin kohor të parashikuar në rregullore, Pala Kontraktuese, në bazë të nënparagrafit (b) dhe neneve 5 dhe 10, mund t'i zbatojë sanksionet e parashikuara në ligjin e saj.

b) Nëse ndonjë kërkesë e aplikuar nga Pala Kontraktuese, sipas paragrafëve (1), (5) ose (6) në lidhje me kërkesën për prioritet, nuk është përmbushur brenda afatit kohor të përcaktuar në rregullore, kërkesa për prioritet, në bazë të nenit 13, mund të konsiderohet si e padepozituar. Në bazë të nenit 5 (7) (b), nuk zbatohet asnjë sanksion tjetër.

Neni 7 Përfaqësimi

1) [Përfaqësuesit e autorizuar]

a) Pala Kontraktuese mund të kërkojë të caktohet një përfaqësues me qëllim ndjekjen e procedurave pranë Zyrës:

i) të gëzojë të drejtën sipas ligjit në fuqi, të ushtrohet pranë Zyrës në lidhje me aplikimet për patentë dhe patentat;

ii) të japë si adresën e tij dhe një adresë në një territor të përcaktuar nga Pala Kontraktuese.

b) Në bazë të nënparagrafit (c), në lidhje me procedurën pranë Zyrës, nga ose në lidhje me një përfaqësues që përmbush kërkesat e aplikuara nga Pala Kontraktuese sipas nënparagrafit (a), do të ketë fuqinë të veprojë nga ose në lidhje me aplikantin, pronarin ose çdo person tjetër të interesuar, i cili e ka caktuar atë përfaqësues.

c) Pala Kontraktuese mund të parashikojë që në rast të një betimi ose deklarate, ose revokimi të prokurës, nënshkrimi i përfaqësuesit nuk do të ketë fuqinë e firmës së aplikantit, pronarit ose çdo personi tjetër të interesuar, i cili e ka caktuar atë përfaqësues.

2) [Përfaqësimi i detyrueshëm]

a) Pala Kontraktuese mund të kërkojë që aplikanti, pronari ose personi tjetër i interesuar të caktojë një përfaqësues me qëllim ndjekjen e procedurës pranë Zyrës, me përjashtim të rastit kur

përfituesi i kërkesës, aplikanti, pronari ose çdo person tjetër i interesuar mund të veprojë vetë pranë Zyrës për ndjekjen e procedurave të mëposhtme:

- i) depozitimin e një aplikimi me qëllim marrjen e datës së depozitimit;
- ii) thjesht për kryerjen e pagesës së një tarife;
- iii) çdo procedurë tjetër të parashikuar në rregullore;
- iv) marrjen e një fature ose njoftimin nga Zyra në lidhje me çdo procedurë të lartpërmendur në pikat (i) deri në (iii).

b) Tarifa e shërbimit mund të paguhet nga çdo person.

3) [Caktimi i përfaqësuesit]. Pala Kontraktuese do të pranojë që caktimi i përfaqësuesit të bëhet pranë Zyrës në mënyrën e parashikuar në rregullore.

4) [Ndalimi i kërkesave të tjera]. Asnjë Palë Kontraktuese nuk mund të kërkojë kërkesa të tjera formale të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafët (1) deri në (3) të përmbushen në lidhje me çështjet e trajtuara në këta paragrafë, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe nga kjo Marrëveshje ose kur parashikohet në rregullore.

5) [Njoftimi]. Në rastin kur një ose më shumë kërkesa të aplikuar nga Pala Kontraktuese sipas paragrafëve (1) deri në (3) nuk përmbushen, Zyra do të njoftojë përfituesin e kërkesës, aplikantin, pronarin ose çdo person tjetër të interesuar, duke i dhënë mundësinë të përmbushë një kërkesë të tillë, të bëjë vërejtjet, brenda afatit kohor të parashikuar në rregullore.

6) [Mospajtueshmëria me kërkesat]. Në rastin kur një ose më shumë kërkesa të aplikuar nga Pala Kontraktuese sipas paragrafëve (1) deri në (3) nuk janë në përputhje me afatin kohor të parashikuar në rregullore, Pala Kontraktuese mund të zbatojë sanksionet e parashikuara në ligjin e saj.

Neni 8

Komunikimet, adresat

1) [Forma dhe mjetet e transmetimit të komunikimeve]

a) Me përjashtim të vendosjes së një date depozitimi në përputhje me nenin 5 (1) dhe në bazë të nenit 6 (1), rregullorja do të përcaktojë, në bazë të nënparagrafëve (b) deri në (d), kërkesat që një Palë Kontraktuese do t'i lejojë aplikimin në lidhje me formën dhe mënyrat e transmetimit të komunikimeve.

b) Asnjë Palë Kontraktuese nuk do të jetë e detyruar të pranojë depozitimin e komunikimeve përveçse atyre në letër.

c) Asnjë Palë Kontraktuese nuk do të jetë e detyruar të përjashtojë depozitimin e komunikimeve në letër.

d) Një Palë Kontraktuese do të pranojë depozitimin e komunikimeve në letër me qëllim respektimin e afatit kohor.

2) [Gjuha e Komunikimeve]. Pala Kontraktuese me përjashtim të rasteve të parashikuara nga kjo Marrëveshje ose rregullore mund të kërkojë që komunikimi të jetë në gjuhën e pranuar nga Zyra.

3) [Formularët standardë ndërkombëtarë]. Pavarësisht paragrafit 1 (a), në bazë të paragrafit (1) (b) dhe nenit 6 (2) (b), Pala Kontraktuese do të pranojë paraqitjen e përmbajtjes së një komunikimi në një formular që korrespondon me formularin standard ndërkombëtar në lidhje me komunikimin e parashikuar nga rregullorja, nëse ka.

4) [Nënshkrimi i komunikimeve]

a) Nëse Pala Kontraktuese kërkon nënshkrim për qëllime të çdo komunikimi, Pala Kontraktuese do të pranojë çdo nënshkrim në përputhje me kërkesat e parashikuara në rregullore.

b) Asnjë Palë Kontraktuese nuk mund të kërkojë vërtetimin, noterizimin, autenticitetin, legalizimin ose çdo vërtetim tjetër nënshkrimi që i komunikohet Zyrës së saj, me përjashtim të rastit të procedimeve pothuajse gjyqësore siç parashikohet në rregullore.

c) Në bazë të nënparagrafit (b), Pala Kontraktuese mund të kërkojë që provat të depozitohen pranë Zyrës, vetëm nëse Zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme për autenticitetin e ndonjë nënshkrimi.

5) [Treguesit në komunikime]. Pala Kontraktuese mund të kërkojë që çdo komunikim të përmbajë një ose më shumë tregues të parashikuar në rregullore.

6) [Adresa për korrespondencë, adresa për shërbimin ligjor dhe ndonjë adresë tjetër]

Pala Kontraktuese mund të kërkojë, në përputhje me dispozitat e parashikuara në rregullore, që një aplikant, pronar ose çdo person tjetër i interesuar, të shënojë në komunikimin:

i) një adresë për korrespondencën;

ii) një adresë për shërbimin ligjor;

iii) çdo adresë tjetër të parashikuar në rregullore.

7) [Njoftimi]. Nëse një ose më shumë kërkesa që aplikohen nga Pala Kontraktuese sipas paragrafëve (1) deri në (6) nuk janë në përputhje me rregullat e komunikimit, Zyra do të njoftojë aplikantin, pronarin ose çdo person tjetër të interesuar, duke i dhënë mundësinë të përmbushë një kërkesë të tillë, të bëjë vërejtjet, brenda afatit kohor të parashikuar në rregullore.

8) [Mospajtueshmëria me kërkesat]. Nëse një ose më shumë kërkesa që aplikohen nga Pala Kontraktuese sipas paragrafëve (1) deri në (6) nuk janë në përputhje me afatin kohor të parashikuar në rregullore, Pala Kontraktuese në bazë të neneve 5 dhe 10 dhe çdo përjashtimi tjetër të parashikuar në këtë rregullore, mund të zbatojë këtë lloj sanksioni në përputhje me ligjin e tij në fuqi.

Neni 9

Njoftimet

1) [Njoftimi i mjaftueshëm]. Çdo njoftim sipas kësaj Marrëveshjeje ose rregulloreje që dërgohet nga Zyra në adresën për korrespondencë ose adresën e shërbimit ligjor të parashikuar në nenin 8 (6) ose çdo adresë tjetër të parashikuar në rregullore me qëllim zbatimin e kësaj dispozite, dhe që përputhet me parashikimet e njoftimit, do të përbëjë një njoftim të mjaftueshëm për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje dhe rregulloreje.

2) [Nëse treguesit që mundësojnë kontaktin nuk janë depozituar]. Asgjë në këtë Marrëveshje dhe në këtë rregullore nuk do të detyrojë Palën Kontraktuese t'i dërgojë njoftim një aplikanti, pronari ose çdo personi tjetër të interesuar, nëse treguesit që mundësojnë aplikantin, pronarin ose çdo person tjetër të interesuar, i cili duhet të kontaktohet, nuk janë depozituar pranë Zyrës.

3) [Pamundësia për t'u njoftuar]. Në bazë të nenit 10 (1), nëse një Zyrë nuk njofton aplikantin, pronarin ose çdo person tjetër të interesuar në pamundësi për të përmbushur kërkesat e kësaj Marrëveshjeje ose rregulloreje, kjo mungesë njoftimi nuk e çliron aplikantin, pronarin ose çdo person tjetër të interesuar nga detyrimi për të përmbushur atë kërkesë.

Neni 10

Vlefshmëria e patentës; revokimi

1) [Vlefshmëria e patentës e pacenuar nga mospërmbushja e disa kërkesave formale] Mospërmbushja e një ose më shumë kërkesave formale të lartpërmendura në nenet (6), (1), [\(2\)](#), [\(4\)](#) dhe [\(5\)](#) dhe [8\(1\) deri në \(4\)](#) në lidhje me një aplikim, mund të mos jetë shkak për revokimin ose zhvleftësimin e një patente, qoftë tërësisht ose pjesërisht, me përjashtim të rastit kur mospërmbushja e kërkesës formale ka ndodhur për qëllim mashtrimi.

2) [Mundësia për bërjen e vërejtjeve, amendimeve ose korrigjimeve në rast revokimi ose zhvleftësimi të synuar]. Një patentë mund të mos revokohet ose zhvleftësohet, qoftë tërësisht ose pjesërisht, pa i dhënë mundësinë pronarit të bëjë vërejtjet mbi revokimin ose zhvleftësimin e synuar, si dhe të bëjë amendime dhe korrigjime nëse lejohet nga ligji në fuqi, brenda afatit kohor të arsyeshëm.

3) [Asnjë detyrim për procedura të veçanta]. Paragrafët (1) dhe (2) nuk krijojnë asnjë detyrim për kryerjen e procedurave gjyqësore në zbatim të të drejtave të patentës, të ndara nga ato për zbatimin e ligjit në përgjithësi.

Neni 11

Lehtësimet në lidhje me afatet kohore

1) [Shtyrja e afateve kohore]. Pala Kontraktuese mund të parashikojë një shtyrje, në lidhje me periudhën e parashikuar në këtë rregullore, të një afati kohor të vendosur nga Zyra për kryerjen e procedurave pranë Zyrës në lidhje me një aplikim për patentë ose patentë, në qoftë se depozitohet një kërkesë për këtë qëllim pranë Zyrës në përputhje me kërkesat e parashikuara në rregullore, dhe nëse kjo kërkesë është depozituar, Pala kontraktuese gëzon të drejtën për të vendosur:

i) para përfundimit të afatit kohor; ose

ii) pas përfundimit të afatit kohor dhe brenda afatit kohor të parashikuar në rregullore.

2) [Përpunimi i vazhdueshëm]. Nëse një aplikant ose pronar nuk ka arritur të përmbushë afatin kohor të vendosur nga Zyra e Palës Kontraktuese për kryerjen e procedurës pranë Zyrës në lidhje me një aplikim ose patentë, dhe kjo Palë Kontraktuese nuk parashikon shtyrjen e një afati kohor sipas paragrafit (1) (ii), Pala Kontraktuese do të parashikojë përpunimin e vazhdueshëm në lidhje me aplikimet për patentë ose patentën dhe nëse është e nevojshme, rivendosjen e të drejtave të aplikantit ose të pronarit në lidhje me aplikimin për patentë ose patentën, nëse:

i) një kërkesë është paraqitur për këtë qëllim pranë Zyrës, në përputhje me kërkesat e parashikuara në rregullore;

ii) kërkesa është depozituar, si dhe të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me të cilat janë përmbushur afatet kohore për veprimet përkatëse sipas afatit kohor të parashikuar në rregullore.

3) [Përfundimet]. Asnjë Pale Kontraktuese nuk mund t'i kërket të parashikojë kushtet lehtësuese të lartpërmendura në paragrafin (1) ose (2) në përputhje me përfundimet e parashikuara në këtë rregullore.

4) [Tarifat]. Pala Kontraktuese mund të kërkojë pagesën e një tarife në lidhje me një nga kërkesat e paragrafit (1) ose (2).

5) [Ndalimi i kërkesave të tjera]. Asnjë Palë Kontraktuese nuk mund të kërkojë që kërkesat e ndryshme nga ato të lartpërmendura nga paragrafët (1) deri në paragrafin (4) të përputhen me kushtet lehtësuese të parashikuara në paragrafin (1) ose (2), me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe nga kjo Marrëveshje ose kjo rregullore.

6) [Mundësia për bërjen e vërejtjeve në rast të refuzimit të synuar]. Një kërkesë në përputhje me paragrafin (1) ose (2) mund të mos refuzohet pa iu dhënë mundësia aplikantit ose pronarit të bëjë vërejtje mbi refuzimin e synuar brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Neni 12

Rivendosja e të drejtave pas një konstatimi të kujdesit të duhur ose veprimit të paqëllimshëm nga ana e Zyrës

1) [Kërkesa]. Pala Kontraktuese duhet të parashikojë që, kur një aplikant ose pronar të ketë dështuar në përmbushjen e afatit kohor për kryerjen e një veprimi në lidhje me procedurën që ndiqet pranë Zyrës, dhe ky dështim ka pasojë të drejtpërdrejtë duke shkaktuar humbjen e të drejtave në lidhje me një aplikim për patentë ose patentë, Zyra duhet të rivendosë të drejtat e aplikantit ose pronarit në lidhje me aplikimin për patentë ose patentën përkatëse, nëse:

i) kërkesa për këtë qëllim depozitohet pranë Zyrës në përputhje me kërkesat e parashikuara në rregullore;

ii) depozitohet kërkesa dhe të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me të cilat është parashikuar ky afat kohor për kryerjen e veprimit, brenda afatit kohor të parashikuar në rregullore;

iii) kërkesa deklaron arsyet për mospërmbushjen e afatit kohor; dhe

iv) Zyra konstaton se mospërmbushja e afatit kohor ka ndodhur, pavarësisht kujdesit të duhur të treguar si pasojë e rrethanave ose zgjedhjes së Palës Kontraktuese se kjo vonesë ka qenë e paqëllimshme.

2) [Përfundimet]. Asnjë Pale Kontraktuese nuk mund t'i kërket të parashikojë rivendosjen e të drejtave parashikuar në paragrafin (1) në lidhje me përfundimet e parashikuara në rregullore.

3) [Tarifat]. Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë pagesën e një tarife në lidhje me kërkesën e parashikuar në paragrafin (1).

4) [Provat]. Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë depozitimin e një deklarate ose prove tjetër në mbështetje të shkaqeve që i referohet paragrafi (1) (iii) pranë Zyrës brenda një afati kohor të vendosur nga Zyra.

5) [Mundësia për bërjen e vërejtjeve në rast të refuzimit të synuar]. Kërkesa në përputhje me paragrafin (1) mund të mos refuzohet, tërësisht ose pjesërisht, pa iu dhënë mundësia palës kërkuese që të kryejë vërejtjet mbi refuzimin e synuar brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Neni 13

Korrigjimi ose plotësimi i pretendimit për prioritet; rivendosja e së drejtës prioritare

1) [Korrigjimi ose plotësimi i pretendimit për prioritet]. Me përjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe në rregullore, Pala Kontraktuese do të parashikojë korrigjimin ose plotësimin e një pretendimi për prioritet në lidhje me një aplikim (aplikimi i mëtejshëm), nëse:

i) një kërkesë bëhet për atë qëllim pranë Zyrës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore;

ii) kërkesa depozitohet brenda afatit kohor të parashikuar në rregullore; dhe

iii) data e depozitimit të aplikimit të mëtejshëm nuk është më e vonshme sesa data e mbarimit të periudhës prioritare të llogaritur nga data e depozitimit të aplikimit më të hershëm, prioriteti i së cilës pretendohet.

2) [Depozitimi i vonuar i aplikimit të mëtejshëm]. Duke marrë në konsideratë nenin 15, Pala Kontraktuese do të parashikojë që, kur në një aplikim (aplikimin e mëtejshëm) që pretendohet ose mund të jetë pretenduar për prioritet të një aplikimi të mëparshëm, i cili ka një datë depozitimi më të vonshme sesa data në të cilën ka përfunduar periudha për prioritet, por brenda afatit kohor të parashikuar në rregullore, Zyra do të rivendosë të drejtën prioritare nëse:

i) një kërkesë është bërë për këtë qëllim pranë Zyrës në përputhje me kërkesat e parashikuara në rregullore;

ii) kërkesa depozitohet brenda afatit kohor të parashikuar në rregullore;

iii) kërkesa deklaron shkaqet e mospërmbushjes së periudhës së parashikuar për prioritet; dhe

iv) Zyra konstaton se mosdepozitimi i kërkesës së mëtejshme brenda periudhës për prioritet, të ndodhur pavarësisht kujdesit të duhur të treguar si pasojë e rrethanave ose zgjedhjes së Palës Kontraktuese, ka qenë e paqëllimshme.

3) [Pamundësia për të depozituar një kopje të aplikimit më të hershëm]. Pala Kontraktuese do të parashikojë që, nëse një kopje e aplikimit më të hershëm të kërkuar sipas nenit 6 (5) nuk depozitohet pranë Zyrës brenda afatit kohor të përcaktuar në rregullore sipas nenit 6, Zyra do të rivendosë të drejtën prioritare nëse:

i) kërkesa është depozituar për atë qëllim pranë Zyrës në përputhje me kërkesat e parashikuara në rregullore;

ii) kërkesa depozitohet brenda afatit kohor për depozitimin e kopjes së aplikimit të mëparshëm të parashikuar në rregullore sipas nenit 6 (5);

iii) Zyra konstaton se kërkesa për kopjen që duhet të jepet, është depozituar pranë Zyrës tek e cila është depozituar aplikimi i mëparshëm, brenda afatit kohor të parashikuar në rregullore; dhe

iv) një kopje e kërkesës së mëparshme depozitohet brenda afatit kohor të parashikuar në rregullore.

4) [Tarifat]. Pala Kontraktuese mund të kërkojë që të kryhet pagesa e një tarife në lidhje me kërkesat sipas paragrafëve (1) deri në (3).

5) [Prova]. Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë që një deklaratë ose provë tjetër, në mbështetje të shkaqeve të përmendura në paragrafin (2) (iii), të depozitohet pranë Zyrës brenda një afati kohor të vendosur nga Zyra.

6) [Mundësia për bërjen e vërejtjeve në rast të refuzimit të synuar]. Një kërkesë në përputhje me paragrafët (1) deri në (3) mund të mos refuzohet, tërësisht ose pjesërisht, pa iu dhënë mundësia palës kërkuuese të kryejë vërejtjet mbi refuzimin e synuar brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Neni 14 **Rregullorja**

- 1) [Përmbajtja]
 - a) Rregullorja e bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje parashikon rregulla në lidhje me:
 - i) çështje që kjo Marrëveshje parashikon shprehimisht duhet të “përcaktohen në rregullore”;
 - ii) hollësitë e dobishme në zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje;
 - iii) procedurat administrative, çështjet ose procedurat.
 - b) Rregullorja parashikon gjithashtu rregulla në lidhje me kërkesat formale që një Pale Kontraktuese i lejohet të aplikojë në lidhje me kërkesat për:
 - i) regjistrimin e një ndryshimi në emër ose adresë;
 - ii) regjistrimin e një ndryshimi tek aplikanti ose pronari;
 - iii) regjistrimin e një licence ose interesi sigurimi;
 - iv) korrigjimin e një gabimi.
 - c) Rregullorja parashikon gjithashtu krijimin e formularëve standardë ndërkombëtarë dhe krijimin e një formulari kërkesë për qëllime të nenit 6 (2) (b) nga Asambleja, me asistencën e Byrosë Ndërkombëtare.
- 2) [Amendimi i rregullores]. Në bazë të paragrafit (3), çdo amendim i rregullores do të kërkojë tri të katërtat e votave të dhëna.
- 3) [Kërkesa e unanimitetit]
 - a) Rregullorja mund të specifikojë dispozitat e rregullores që mund të amendohen vetëm unanimisht.
 - b) Çdo amendim i rregullores që çon në shtimin e dispozitave ose heqjen e dispozitave nga dispozitat e specifikuar në rregullore sipas nënparagrafit (a) do të kërkojë unanimitet.
 - c) Në përcaktimin nëse është arritur unanimiteti, vetëm votat e dhëna aktualisht do të merren në konsideratë. Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota.
- 4) [Konflikti midis Marrëveshjes dhe rregullores]. Në rast të konfliktit midis dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe atyre të rregullores, dispozitat e Marrëveshjes do të kenë përparësi.

Neni 15 **Marrëdhënia me Konventën e Parisit**

- 1) [Detyrimi për t’u pajtuar me Konventën e Parisit]. Secila Palë Kontraktuese do të pajtohet me dispozitat e Konventës së Parisit që kanë lidhje me patentat.
- 2) [Detyrimet dhe të drejtat sipas Konventës së Parisit]
 - a) Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të heqë detyrimet që Palët Kontraktuese kanë ndaj njëra-tjetrës sipas Konventës së Parisit.
 - b) Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të heqë të drejtat që aplikantët dhe pronarët gëzojnë në përputhje me dispozitat e Konventës së Parisit.

Neni 16 **Fuqia e rishikimeve, amendimeve dhe modifikimeve të Marrëveshjes së bashkëpunimit për patentat**

- 1) [Zbatueshmëria e rishikimeve, amendimeve dhe modifikimeve të Marrëveshjes së bashkëpunimit për patentat]. Në bazë të paragrafit (2), çdo rishikim, amendim ose modifikim i Marrëveshjes së bashkëpunimit për patentat, të bërë pas datës 2 qershor 2000, që është në pajtim me nenet e kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohet për qëllime të kësaj Marrëveshjeje dhe rregulloreje nëse Asambleja vendos këtë, veçanërisht nga tri të katërtat e votave të dhëna.

2) [Moszbatueshmëria e dispozitave të përkohshme të Marrëveshjes së bashkëpunimit për patentat]. Çdo dispozitë e Marrëveshjes së bashkëpunimit për patentat, në bazë të së cilës një dispozitë e rishikuar, e amenduar ose e modifikuar e asaj Marrëveshjeje nuk zbatohet për një Shtet Palë në të ose për Zyrën e atij shteti ose që vepron për atë Shtet për sa kohë që kjo dispozitë është e papajtueshme me ligjin e zbatuar nga shteti ose Zyra, nuk zbatohet për qëllime të kësaj Marrëveshjeje dhe rregulloreje.

Neni 17 Asambleja

1) [Përbërja]

a) Palët Kontraktuese do të kenë një Asamble.

b) Secila Palë Kontraktuese do të përfaqësohet në Asamble nga një delegat që mund të asistohet nga delegatë, këshilltarë ose ekspertë të alternuar. Secili delegat mund të përfaqësojë vetëm një Palë Kontraktuese.

2) [Detyrat]. Asambleja:

i) do të trajtojë çështjet në lidhje me ruajtjen dhe zhvillimin e kësaj Marrëveshjeje dhe aplikimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

ii) do të krijojë formularë standard ndërkombëtar dhe formularin e kërkesës së përmendur në nenin 14 (1) (c), me asistencën e Byrosë Ndërkombëtare;

iii) do të amendojë rregulloren;

iv) do të caktojë kushtet për datën e aplikimit të formularit standard ndërkombëtar dhe formularin e kërkesës të përmendur në pikën (ii) dhe secilin amendim të përmendur në pikën (iii);

v) do të vendosë sipas nenit 16 (1) nëse ndonjë rishikim, amendim ose modifikim i Marrëveshjes së bashkëpunimit për patentat, do të aplikohet për qëllime të kësaj Marrëveshjeje dhe rregulloreje;

vi) do të përmbushë funksione të tjera të tilla që janë të përshtatshme sipas kësaj Marrëveshjeje.

3) [Kuorumi]

a) Gjysma e anëtarëve të Asamblesë që janë shtete do të përbëjë një kuorum.

b) Pavarësisht nënparagrafit (a), nëse në ndonjë sesion, numri i anëtarëve të Asamblesë që janë shtete dhe përfaqësohen është më pak se gjysma, por i barabartë me ose më shumë se një e treta e anëtarëve të Asamblesë që janë shtete, Asambleja mund të marrë vendime, por me përjashtim të vendimeve në lidhje me procedurën e saj, të gjitha këto vendime do të kenë fuqi vetëm nëse janë përmbushur kushtet e parashtruara në vijim. Byroja Ndërkombëtare do t'ua komunikojë vendimet e mësipërme anëtarëve të Asamblesë që janë shtete dhe nuk përfaqësohen dhe do t'i ftojë ata të shprehin me shkrim votën ose abstenimin e tyre brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e komunikimit. Nëse, me mbarimin e kësaj periudhe, numri i këtyre anëtarëve, që e kanë shprehur në këtë mënyrë votën ose abstenimin e tyre, arrin numrin e anëtarëve që mungonte për arritjen e kuoromit në sesion, këto vendime do të marrin fuqi, me kusht që në të njëjtën kohë të arrihet ende shumica e kërkuar.

4) [Marrja e vendimeve në Asamble]

a) Asambleja do të bëjë përpjekje që të marrë vendimet me konsensus.

b) Nëse një vendim nuk mund të arrihet me konsensus, çështja në fjalë do të vendoset me anë të votimit. Në këtë rast:

i) secila Palë Kontraktuese që është shtet do të ketë një votë dhe do të votojë vetëm në emrin e saj; dhe

ii) çdo Palë Kontraktuese që është organizatë ndërqeveritare mund të marrë pjesë në votim në vend të Shteteve të saj Anëtare, me numër votash të barabartë me numrin e Shteteve të saj Anëtare që janë palë të kësaj Marrëveshjeje. Asnjë organizatë e tillë ndërqeveritare nuk do të marrë pjesë në votim nëse ndonjë prej Shteteve Anëtare të saj ushtron të drejtën për të votuar dhe anasjelltas. Për më tepër, asnjë organizatë e tillë ndërqeveritare nuk do të marrë pjesë në votim,

nëse ndonjë prej Shteteve të saj Anëtare, palë të kësaj Marrëveshjeje, është Shtet Anëtar i një organizate tjetër të tillë ndërqeveritare dhe ajo organizatë tjetër ndërqeveritare merr pjesë në atë votim.

5) [Shumicat]

a) Në bazë të neneve 14(2) dhe (3), 16(1) dhe 19(3), vendimet e Asamblesë do të kërkojnë dy të tretat e votave të dhëna.

b) në përcaktimin nëse është arritur shumica e kërkuar, vetëm votat e dhëna aktualisht do të merren në konsideratë. Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota.

6) [Sesionet]. Asambleja do të mbledhet në sesion të zakonshëm një herë në dy vjet nga Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale.

7) [Rregullat e procedurës]. Asambleja do të vendosë rregullat e veta të procedurës, duke përfshirë rregullat për thirrjen e sesioneve të jashtëzakonshme.

Neni 18

Zyra ndërkombëtare

1) [Detyrat administrative]

a) Zyra do të përmbushë detyra administrative në lidhje me këtë Marrëveshje.

b) Në mënyrë të veçantë, Zyra Ndërkombëtare do të përgatisë takime dhe do të sigurojë sekretariatin e Asamblesë dhe të atyre komiteteve të ekspertëve dhe grupeve të punës që mund të krijohen nga Asambleja.

2) [Takimet e ndryshme nga sesionet e Asamblesë]. Drejtori i Përgjithshëm do të mbledhë çdo komitet dhe grup pune të krijuar nga Asambleja.

3) [Roli i Zyrës Ndërkombëtare në Asamble dhe takime të tjera]

a) Drejtori i Përgjithshëm dhe personat e caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm do të marrin pjesë pa të drejtë vote në të gjitha takimet e Asamblesë, komitetet dhe grupet e punës të krijuara nga Asambleja.

b) Drejtori i Përgjithshëm ose një anëtar stafi i caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm do të jetë sekretari i caktuar kryesisht i Asamblesë dhe i komiteteve dhe grupeve të punës të lartpërmendura në nënparagrafin (a).

4) [Konferencat]

a) Në përputhje me direktivat e Asamblesë, Zyra Ndërkombëtare do të bëjë përgatitje për çdo konferencë rishikimi.

b) Zyra Ndërkombëtare mund të konsultohet me Shtetet Anëtare të Organizatës, organizatat ndërqeveritare dhe organizatat joqeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me përgatitjet e lartpërmendura.

c) Drejtori i Përgjithshëm dhe personat e caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm do të marrin pjesë pa të drejtë vote në diskutimet në konferencat e rishikimit.

5) [Detyra të tjera]. Zyra Ndërkombëtare do të kryejë çdo detyrë tjetër të caktuar asaj në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 19

Rishikimet

1) [Rishikimi i Marrëveshjes]. Në bazë të paragrafit (2), kjo Marrëveshje mund të rishikohet nga një konferencë e Palëve Kontraktuese. Thirrja e një konference rishikimi do të vendoset nga Asambleja.

2) [Rishikimi ose amendimi i disa dispozitave të Marrëveshjes]. Neni 17 (2) dhe (6) mund të amendohen ose nga një konferencë rishikimi, ose nga Asambleja, sipas dispozitave të paragrafit (3).

3) [Amendimi nga Asambleja i disa dispozitave të Marrëveshjes].

a) Propozimet për amendimin nga Asambleja të nenit 17 (2) dhe (6) mund të fillojnë me iniciativën e secilës Palë Kontraktuese ose nga Drejtori i Përgjithshëm. Këto propozime do t'i

komunikohen nga Drejtori i Përgjithshëm Palëve Kontraktuese të paktën gjashtë muaj përpara shqyrtimit të tyre nga Asambleja.

b) Miratimi i çdo amendimi të dispozitave të përmendura në nënparagrafin (a) do të kërkojë tri të katërtat e votave të dhëna.

c) Çdo amendim i dispozitave të përmendura në nënparagrafin (a) do të hyjë në fuqi një muaj pas njoftimit me shkrim të pranimit, të bërë në përputhje me proceset e tyre përkatëse kushtetuese, të marrë nga Drejtori i Përgjithshëm, nga tri të katërtat e Palëve Kontraktuese që ishin anëtarë të Asamblesë në kohën që Asambleja ka miratuar amendamentin. Çdo amendim i dispozitave të mësipërme të pranuar në këtë mënyrë, do të detyrojë të gjitha Palët Kontraktuese në kohën që amendimi hyn në fuqi dhe shtetet dhe organizatat ndërqeveritare që bëhen Palë Kontraktuese në një datë të mëvonshme.

Neni 20

Anëtarësimi në Marrëveshje

1) [Shtetet]. Çdo shtet që është palë e Konventës së Parisit ose që është anëtar i Organizatës dhe në lidhje me të cilin mund të jepen patentat ose nëpërmjet Zyrës së shtetit të saj, ose nëpërmjet Zyrës së shtetit tjetër ose organizatës ndërqeveritare, mund të bëhet palë e kësaj Marrëveshjeje.

2) [Organizatata ndërqeveritare]. Çdo organizatë ndërqeveritare mund të bëhet palë e kësaj Marrëveshjeje, nëse të paktën një shtet anëtar i asaj organizate ndërqeveritare është palë e Konventës së Parisit ose një anëtar i Organizatës, dhe organizata ndërqeveritare deklaron se ka qenë e autorizuar rregullisht, në përputhje me procedurat e saj të brendshme, të bëhet palë e kësaj Marrëveshjeje dhe deklaron se:

i) është kompetente për dhënien e patentave për shtetet e saj anëtare; ose

ii) është kompetente në lidhje me dhe ka legjislacionin e saj detyrues për të gjitha Shtetet e saj Anëtare mbi çështjet që përfshin kjo Marrëveshje dhe ka ngarkuar një zyrë rajonale me qëllim dhënien e patentave në territorin e saj, në përputhje me legjislacionin e tyre në fuqi.

Në bazë të paragrafit (3), çdo deklaratë e tillë do të bëhet në kohën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose aderimit.

3) [Organizatata rajonale të patentave]. Organizata Europiane e Patentave, Organizata Euroaziatike e Patentave dhe Organizata Rajonale Afrikane e Pronësisë Industriale, duke bërë deklaratën e përmendur në paragrafin (2) (i) ose (ii) në Konferencën Diplomatike që ka miratuar këtë Marrëveshje, mund të bëhen palë të kësaj Marrëveshjeje si organizata ndërqeveritare, nëse deklarojnë, në kohën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose aderimit, se kanë qenë të autorizuar rregullisht në përputhje me procedurat e tyre të brendshme, të bëhen palë e kësaj Marrëveshjeje.

4) [Ratifikimi ose aderimi]. Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare që plotëson kërkesat në paragrafin (1), (2) ose (3), mund të depozitojë:

i) një instrument ratifikimi nëse ka nënshkruar këtë Marrëveshje; ose

ii) një instrument aderimi nëse nuk e ka nënshkruar këtë Marrëveshje.

Neni 21

Hyrja në fuqi; data e hyrjes në fuqi të ratifikimeve dhe aderimeve

1) [Hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje]. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi tre muaj pasi dhjetë instrumentet e ratifikimit ose aderimit nga shtetet të jenë depozituar pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

2) [Datat e hyrjes në fuqi të ratifikimeve dhe aderimeve]. Kjo Marrëveshje do të detyrojë:

i) dhjetë shtetet e lartpërmendura në paragrafin (1) nga data në të cilën kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi;

ii) çdo shtet tjetër, nga përfundimi i kësaj periudhe tremujore pas datës në të cilën shteti ka depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose aderimit pranë Drejtorit të Përgjithshëm ose nga çdo

datë e mëvonshme e treguar në atë instrument, por jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së këtij depozitimi;

iii) secila prej: Organizatës Europiane të Patentave, Organizatës Euroaziatike të Patentave dhe Organizatës Rajonale Afrikane të Pronësisë Industriale, nga përfundimi i periudhës prej tre muaj pas depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit ose aderimit ose nga çdo datë e mëvonshme e treguar në atë instrument, por jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së këtij depozitimi, nëse ky instrument është depozituar pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje sipas paragrafit (1), ose tre muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje nëse ky instrument është depozituar para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje;

iv) çdo organizatë tjetër ndërqeveritare që plotëson kriteret për t'u bërë palë e kësaj Marrëveshjeje nga përfundimi i periudhës tremujore pas depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit ose aderimit, ose nga çdo datë e mëvonshme e treguar në atë instrument, por jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së këtij depozitimi.

Neni 22

Aplikimi i Marrëveshjes ndaj kërkesave ekzistuese dhe patentave

1) [Parimi]. Në bazë të paragrafit (2), një Palë Kontraktuese do të zbatojë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe rregulloreje, të ndryshme nga nenet 5 dhe 6 (1) dhe (2) dhe rregulloret e ngjashme për aplikimet e papërfunduara dhe patentat që janë në fuqi në datën në të cilën kjo Marrëveshje detyron atë Shtet Kontraktues sipas nenit 21.

2) [Procedurat]. Asnjë Palë Kontraktuese nuk do të jetë e detyruar të zbatojë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe rregulloreje për ndonjë procedurë në procedimet në lidhje me kërkesat dhe patentat e përmendura në paragrafin (1), nëse një procedurë e tillë ka filluar para datës në të cilën kjo Marrëveshje detyron atë Palë Kontraktuese sipas nenit 21.

Neni 23

Rezervat

1) [Rezervat]. Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare mund të deklarojë nëpërmjet një rezerve që dispozitat e nenit 6 (1) nuk zbatohen për ndonjë kërkesë në lidhje me unitetin e shpikjes që zbatohet sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit për patentat për një aplikim ndërkombëtar.

2) [Modalitetet]. Çdo rezervë e bërë sipas paragrafit (1) do të bëhet në një deklaratë që shoqëron instrumentin e ratifikimit ose aderimit në këtë Marrëveshje të shtetit ose organizatës ndërqeveritare që bën rezervën.

3) [Tërheqja]. Çdo rezervë sipas paragrafit (1) mund të tërhiqet në çdo kohë.

4) [Ndalimi i rezervave të tjera]. Nuk do të lejohet asnjë rezervë në këtë Marrëveshje, e ndryshme nga rezerva e lejuar sipas paragrafit (1).

Neni 24

Denoncimi i Marrëveshjes

1) [Njoftimi]. Çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje me anë të një njoftimi të drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm.

2) [Data e hyrjes në fuqi]. Çdo denoncim do të ketë fuqi një vit nga data në të cilën Drejtori i Përgjithshëm ka marrë njoftim ose në çdo datë të mëvonshme të treguar në njoftim. Ajo nuk do të cenojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për çdo aplikim të papërfunduar ose çdo patentë në fuqi në lidhje me Palën Kontraktuese denoncuese në kohën e hyrjes në fuqi të denoncimit.

Neni 25
Gjuhët e Marrëveshjes

1) [Tekstet autentike]. Kjo Marrëveshje nënshkruhet në një origjinal të vetëm në gjuhën angleze, arabe, kineze, frënge, ruse dhe spanjolle, të gjitha tekstet njëlloj dhe ekskluzivisht autentike.

2) [Tekstet zyrtare]. Një tekst zyrtar në çdo gjuhë të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafin (1) do të vendoset nga Drejtori i Përgjithshëm pas konsultimit me palët e interesuara. Për qëllime të këtij paragrafi, pala e interesuar nënkupton çdo shtet që është palë e Marrëveshjes ose që pranohet për t'u bërë palë e Marrëveshjes sipas nenit 20 (1), gjuha zyrtare e së cilës ose një prej gjuhëve zyrtare të së cilës është përfshirë, dhe Organizata Europiane e Patentave, Organizata Euroaziatike e Patentave dhe Organizata Rajonale Afrikane e Pronësisë Industriale dhe çdo organizatë tjetër ndërqeveritare që është palë e Marrëveshjes ose që mund të bëhet palë e Marrëveshjes, nëse përfshihet një prej gjuhëve të saj zyrtare.

3) [Tekstet autentike që duhet të kenë përparësi]. Në rast mospërputhje të opinionit mbi interpretimin midis teksteve autentike dhe zyrtare, tekstet autentike do të kenë përparësi.

Neni 26
Nënshkrimi i Marrëveshjes

Marrëveshja do të mbetet e hapur për nënshkrim nga çdo shtet që pranohet për t'u bërë palë e Marrëveshjes sipas nenit 20 (1) dhe nga Organizata Europiane e Patentave, Organizata Euroaziatike e Patentave dhe Organizata Rajonale Afrikane e Pronësisë Industriale në selinë e Organizatës për një vit pas miratimit të saj.

Neni 27
Depozitari, regjistrimi

1) [Depozitari]. Drejtori i Përgjithshëm është depozitar i kësaj Marrëveshjeje.

2) [Regjistrimi]. Drejtori i Përgjithshëm do ta regjistrojë këtë Marrëveshje pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

**Deklaratat e rëna dakord nga Konferenca Diplomatike në lidhje me Marrëveshjen mbi
ligjin e Patentave**
dhe rregulloret sipas Marrëveshjes mbi ligjin e patentave**

1) Gjatë miratimit të nenit 1 (xiv), Konferenca Diplomatike kuptoi që fjalët “procedura pranë Zyrës” nuk do të mbulonin procedurat gjyqësore sipas ligjit të zbatueshëm.

2) Gjatë miratimit të nenit 1 (xvii), 16 dhe 17 (2) (v), Konferenca Diplomatike kuptoi që:

1) Asambleja PLT, sipas rastit, do të mbledhet në lidhje me takimet e Asamblesë PCT.

2) Palët Kontraktuese të PLT-së, do të mbledheshin sipas rastit, përveç Shteteve Palë të PCT-së, në lidhje me modifikimet e propozuara të udhëzimeve administrative të PCT-së.

3) Drejtori i Përgjithshëm do të propozojë për përcaktimin e Asamblesë PCT, që Palët Kontraktuese të PLT-së, të cilat nuk janë palë në PCT, të ftohen si vëzhguese në mbledhjet e Asamblesë PCT dhe në mbledhjet e organeve të tjera të PCT-së, sipas rastit.

4) Kur Asambleja e PLT-së vendos sipas nenit 16 që një rishikim, amendim ose modifikim i PCT-së do të zbatohet për qëllimet e PLT-së, Asambleja mund të parashikojë dispozita të përkohshme sipas PLT-së në ndonjë rast të veçantë.

**titulli zyrtar në gjuhën angleze.

Burimi: Byroja Ndërkombëtare e WIPO.

Shënim. Vetëm deklaratat e rëna dakord në lidhje me Marrëveshjen mbi ligjin e patentave janë riprodhuar këtu. Për marrëveshjet e rëna dakord në lidhje me rregullret sipas Marrëveshjes mbi ligjin për patentat shih ligjet dhe Marrëveshjet mbi pronësinë industriale, marrëveshjet multilaterale-Teksti 2-016.

3) Gjatë miratimit të nenit 6 (5) dhe 13 (3) dhe rregullave 4 dhe 14, Konferenca Diplomatike inkurajoi Organizatën Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale për të shpejtuar krijimin e një sistemi biblioteke dixhitale për dokumentet prioritare. Një sistem i tillë do të ishte i dobishëm për pronarët e patentave dhe të tjerë që dëshirojnë të kenë akses në dokumente prioritare.

4 dhe 5...¹.

6. Ishte rënë dakord që çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet dy ose më shumë Palëve Kontraktuese në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe rregulloreve të saj, mund të zgjidhet miqësisht nëpërmjet konsultimit ose ndërmjetësimit, nën kujdesin e Drejtorit të Përgjithshëm.

LIGJ

Nr.10 181, datë 29.10.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR, 2002”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar, 2002”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6340, datë 17.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

¹ Shih ligjet dhe marrëveshjet mbi pronësinë industriale marrëveshjet multilaterale Teksti 2-1016 (shënim i redaktorit)

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR (2002)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë

në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë,

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje,
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,
duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 20 nëntor 2002 në Tiranë,
u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe/ose marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi me vlefte prej 7 500 000--euro (me fjalë: shtatë milionë e pesëqind mijë euro) për projektin "Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Shkodrës".

2. Nëse Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë bien dakord, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të lidhet midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësit të shumës së financimit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftehet, në rast se kontratat përkatëse për financim nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2010.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai nuk është vetë marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendime eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratës për financim, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e shumës së financimit, si dhe nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rast se duhet lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më datë ----- në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave
të Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e
Republikës Federale të Gjermanisë

LIGJ

Nr.10 182, datë 29.10.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E KONFERENCËS SË HAGËS “PËR PROCEDURËN CIVILE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika Shqipërisë aderon në konventën e Konferencës së Hagës “Për procedurën civile”, hyrë në fuqi më 12 prill 1957.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6341, datë 17.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONVENTA PËR PROCEDURËN CIVILE

(përfunduar më 1 mars 1954
& hyrë në fuqi më 12 prill 1957)

Shtetet palë në këtë Konventë,
me dëshirën për të bërë përmirësimet e sugjeruara nga përvoja, në Konventën mbi
Procedurën Civile të datës 17 korrik 1905,
vendosën të përfundojnë këtë Konventë dhe të merren vesh përsa u përket dispozitave të
mëposhtme:

I. KOMUNIKIMI I DOKUMENTEVE GJYQËSORE DHE JASHTËGJYQËSORE

Neni 1

Në çështjet civile dhe tregtare, dërgimi i dokumenteve që u adresohen personave jashtë
vendit do të kryhet në shtetet kontraktuese nëpërmjet kërkesës së një konsulli të shtetit që bën
kërkesën, drejtuar autoritetit që do të caktohet nga shteti që i adresohet kjo kërkesë. Kërkesa, që
specifikon autoritetin e origjinës së dokumentit të dërguar, emrat dhe kompetencat e palëve, adresën
e marrësit dhe natyrën e dokumentit në fjalë duhet të jenë në gjuhën e autoritetit që i bëhet kërkesa.
Ky autoritet duhet t'i dërgojë konsullit certifikatën që tregon dërgimin ose që tregon faktin që e ka
penguar atë.

Të gjitha vështirësitë që mund të lindin në lidhje me kërkesën e konsullit, do të zgjidhen
nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Çdo shtet kontraktues mund të deklarojë, nëpërmjet një komunikate që i drejtohet shteteve të
tjera kontraktuese, se ai shpreh dëshirën që kërkesat për dërgimin që kryhen në territorin e tij, duke
iu përmbajtur specifikimeve të përmendura në paragrafin e parë, duhet t'i drejtohen atij nëpërmjet
rrugëve diplomatike.

Dispozitat e mësipërme nuk i pengojnë dy shtete kontraktuese që të bien dakord për lejimin
e komunikimit të drejtpërdrejtë midis autoriteteve të tyre respektive.

Neni 2

Dërgimi do të kryhet nga ana e autoritetit që është kompetent sipas ligjeve të shtetit që i
drejtohet kërkesa. Ky autoritet, me përjashtim të rasteve të përmendura në nenin 3, mund të kufizojë
veten duke ia dërguar dokumentin një marrësi që e pranon atë vullnetarisht.

Neni 3

Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentin që do të dërgohet në dy kopje.

Nëse dokumenti që do të dërgohet, është shkruar në gjuhën e autoritetit që i drejtohet
kërkesa apo në gjuhën që është rënë dakord midis dy shteteve të interesuara, ose nëse ai është i
shoqëruar me një përkthim në njërën prej këtyre gjuhëve, autoritetit që i drejtohet kërkesa, nëse kjo
kërkesë shpreh dëshirën, duhet të dërgojë dokumentin me një metodë të përshtatshme me anë të
legjislacionit kombëtar për kryerjen e një dërgimi të tillë ose me anë të një metode specifike,
përveçse në rastet kur këto bien në kundërshtim me atë ligj. Nëse një dëshirë e tillë nuk është
shprehur, atëherë autoriteti që i drejtohet kërkesa duhet që fillimisht të kërkojë të kryejë dërgesën në
përputhje me nenin 2.

Përveçse kur ka marrëveshje në kundërshtim me këtë, përkthimi i bërë sipas paragrafit të
mëparshëm, do të certifikohet si i saktë nga zyrtari diplomatik ose agjenti konsullor i shtetit që bën
kërkesën ose nga një përkthyes i licencuar i shtetit, të cilit i është drejtuar kërkesa.

Neni 4

Kur një kërkesë për dërgime është në përputhje me nenet 1, 2 dhe 3, shteti në territorin e të cilit do të kryhet kjo kërkesë mund të refuzojë të jetë dakord me të vetëm nëse ai gjykon se rënia dakord mund të cenojë sovranitetin dhe sigurinë e tij.

Neni 5

Dërgimi duhet të provohet nëpërmjet një vërtetimi të legalizuar dhe të datuar nga ana e marrësit ose të një certifikate nga ana e autoritetit të shtetit të cilit i drejtohet kërkesa, me anë të së cilës përcaktohet prova, metoda dhe data e dërgimit.

Vërtetimi i legalizuar ose certifikata duhet të vendoset në një prej të dy kopjeve të dokumentit të dërguar ose t'i bashkëlidhen atij.

Neni 6

Dispozitat e neneve të mësipërme nuk duhet të bien ndesh me:

1) lirinë për dërgimin e dokumenteve nëpërmjet rrugëve postare, drejtpërdrejt personave të interesuar jashtë shtetit;

2) lirinë e personave të interesuar për të përfituar dërgime të kryera drejtpërdrejt nëpërmjet oficerëve gjyqësorë ose zyrtarëve kompetentë të vendit të destinacionit;

3) lirinë e secilit shtet për të përfituar dërgime të kryera drejtpërdrejt nëpërmjet agentëve të tij diplomatikë apo konsullorë për dokumentet që kanë si objekt personat jashtë shtetit.

Në secilin prej këtyre rasteve, liria e përmendur duhet të ekzistojë vetëm nëse lejohet nga konventat e lidhura midis shteteve të interesuara ose nëse nuk ekziston ndonjë konventë, shteti në territorin e të cilit do të kryhet dërgimi nuk ka kundërshtime. Ky shtet mund të mos ketë kundërshtime kur, në rastet e përmendura në nënparagrafin 3 të paragrafit të mësipërm, dokumenti duhet të dërgohet pa asnjë lloj detyrimi mbi një shtetas të shtetit që bën kërkesën.

Neni 7

Dërgimi i dokumenteve gjyqësore nuk duhet të shkaktojë rimbursimin e taksave apo të shpenzimeve të çdo lloj natyre.

Megjithatë, nëse nuk ka ndonjë marrëveshje kundërshtuese, shteti që merr kërkesën, do të ketë të drejtën të kërkojë nga shteti që bën kërkesën rimbursimin e shpenzimeve të rastit që lidhen me punësimin e një oficeri gjyqësor ose me përdorimin e një metode specifike dërgimi sipas rasteve të përmendura në nenin 3.

II. LETËRKËRKESAT

Neni 8

Në çështjet civile ose tregtare, një autoritet gjyqësor i një shteti kontraktues mund të aplikojë, në përputhje me dispozitat e ligjit të atij shteti, nëpërmjet një letërkërkesë, ndaj autoritetit kompetent të një shteti tjetër kontraktues, duke i kërkuar atij autoriteti, brenda fushës së juridiksionit të tij, të sigurojë prova ose të kryejë ndonjë akt tjetër gjyqësor.

Neni 9

Letërkërkesat transmetohen nëpërmjet konsullit të shtetit që bën kërkesën për autoritetin që do të caktohet nga shteti që bën ekzekutimin e saj. Ky autoritet do t'i dërgojë konsullit dokumentin që vendos ekzekutimin e letërkërkesës ose tregon provën dhe shkaqet që kanë penguar ekzekutimin e saj.

Çdo vështirësi që mund të lindë në lidhje me transmetimin, duhet të zgjidhet nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Çdo shtet kontraktues mund të deklarojë, nëpërmjet një komunikate të drejtuar shteteve të tjera kontraktuese, që ky shtet shpreh dëshirën që çdo letërkërkesë për t'u ekzekutuar në territorin e tij duhet t'i transmetohet atij nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Dispozitat e mësipërme nuk i pengojnë dy shtete kontraktuese që të bien dakord për të lejuar transmetim të drejtpërdrejtë të letërkërkesave midis autoriteteve të tyre respektive.

Neni 10

Përveçse në rastet kur ka një marrëveshje kundërshtuese, letërkërkesat duhet të shkruhen ose në gjuhën e autoritetit që i drejtohet kërkesa, ose në gjuhën e rënë dakord midis dy shteteve të interesuara, ose ato duhet të shoqërohen me një përkthim në një prej këtyre gjuhëve dhe të certifikuar si të saktë nga një zyrtar diplomatik ose agent konsullor i shtetit të origjinës së kërkesës, ose nga një përkthyes i licencuar i shtetit që do të bëjë ekzekutimin e saj.

Neni 11

Autoriteti gjyqësor, të cilit i është drejtuar letërkërkesa, është i detyruar ta respektojë atë duke përdorur të njëjtat masa detyruese, si dhe për ekzekutimin e urdhrave të lëshuara nga autoritetet e shtetit që bën ekzekutimin ose të kërkesave të bëra nga palët në procedimet e brendshme. Këto masa detyruese nuk do të përdoren domosdoshmërisht në rastet kur përfshihet paraqitja e palëve në procedime të brendshme.

Autoriteti që bën kërkesën, nëse e kërkon një gjë të tillë, duhet të informohet mbi datën dhe vendin e ekzekutimit të masës së kërkuar, në mënyrë që palës së interesuar t'i krijohet mundësia të jetë e pranishme.

Ekzekutimi i letërkërkesës mund të refuzohet vetëm në rastet kur:

- 1) nuk është saktësuar vërtetësia e dokumentit;
- 2) në shtetin që bëhet ekzekutimi, ekzekutimi i letërkërkesës nuk është brenda fushës së përgjegjësisë së gjyqësorit;
- 3) shteti, në territorin e të cilit do të kryhet ekzekutimi, çmon se ky ekzekutim cenon sovranitetin dhe sigurinë e tij.

Neni 12

Nëse autoriteti të cilit i është transmetuar një letërkërkesë, nuk është kompetent për ta ekzekutuar atë, letra duhet t'i dërgohet automatikisht autoritetit përkatës në të njëjtin shtet, i cili është kompetent për ekzekutimin e tij në përputhje me dispozitat e ligjit të këtij vendi.

Neni 13

Në të gjitha rastet, kur letërkërkesa nuk është ekzekutuar nga ana e autoritetit që i drejtohet kjo letër, kjo e fundit duhet ta njoftojë menjëherë autoritetin që ka bërë kërkesën, duke treguar, në rastin e nenit 11, arsyet e refuzimit të ekzekutimit të letrës dhe, në rastin e nenit 12, autoritetin përkatës të cilit i është transmetuar kjo letër.

Neni 14

Autoriteti gjyqësor që ekzekuton një letërkërkesë zbaton ligjin e vendit të vet përsa i përket metodave dhe procedurave që do të ndiqen.

Megjithatë, ky autoritet mund të plotësojë një kërkesë të autoritetit që bën kërkesën në lidhje me ndjekjen e një metode apo procedure specifike, përveçse në rastet kur ato bien në kundërshtim me ligjin në fuqi të shtetit ku do të kryhet ekzekutimi.

Neni 15

Dispozitat e neneve të mësipërme nuk përjashtojnë të drejtën e secilit shtet për të ekzekutuar drejtpërdrejt letërkërkesat, nëpërmjet zyrtarëve diplomatikë ose agjentëve konsullorë të tij, nëse kjo lejohet nga konventat e lidhura midis shteteve të interesuara ose nëse shteti në territorin e të cilit do të ekzekutohet letra nuk ka kundërshtim për këtë.

Neni 16

Ekzekutimi i letërkërkesave nuk duhet të shkaktojë rimbursim të taksave apo të shpenzimeve të çdo lloji natyre.

Megjithatë, në rastet kur nuk ekziston ndonjë marrëveshje kundërshtuese, shteti që kryen ekzekutimin, ka të drejtën t'i kërkojë shtetit të origjinës rimbursimin e shpenzimeve të rastit që lidhen me tarifat e paguara për dëshmitarët ose ekspertët, të shpenzimeve për punësimin e ndonjë oficeri gjyqësor, të cilat bëhen të nevojshme kur dëshmitarët nuk paraqiten vullnetarisht, si dhe të shpenzimeve që rezultojnë nga zbatimi i paragrafit të dytë të nenit 14.

III. SIGURIA PËR SHPENZIMET

Neni 17

Asnjë siguri, obligacion ose depozitë e çdo lloji nuk mund të vendoset për arsye të kombësisë së tyre të huaj, ose për shkak të mungesës së vendbanimit apo rezidencës në vend, mbi shtetasit e një prej shteteve kontraktuese, që e kanë vendbanimin e tyre në njërin nga këto shtete, dhe që janë palë paditëse ose palë ndërmjetëse para gjykatave të një prej këtyre shteteve.

I njëjti rregull do të respektohet për çdo pagesë të kërkuar nga pala paditëse apo pala ndërmjetëse si siguri për shpenzimet e gjykatës.

Të gjitha konventat, për të cilat shtetet kontraktuese kanë rënë dakord që shtetasit e tyre të përjashtohen nga dhënia e sigurisë për kostot ose për pagesat për shpenzimet gjyqësore, pavarësisht nga vendbanimi i tyre, do të vazhdojnë të zbatohen.

Neni 18

Urdhrat për kostot dhe shpenzimet e seancave gjyqësore, të bëra në një nga shtetet kontraktuese kundër palës paditëse apo asaj ndërmjetëse të përjashtuara nga masa e sigurisë, depozitës apo pagesës sipas paragrafit të parë dhe të dytë të nenit 17, ose sipas ligjit të shtetit ku ka filluar gjykimi, përmes kërkesës së bërë nëpërmjet rrugëve diplomatike, do të bëhen të zbatueshme pa ndonjë detyrim financiar nga autoriteti kompetent, në secilin nga vendet e tjera të shteteve kontraktuese.

I njëjti rregull do të zbatohet edhe për vendimet gjyqësore për të cilat sasia e shpenzimeve të seancave gjyqësore është përcaktuar në vijim.

Asgjë sa shprehet në dispozitat e mësipërme nuk i pengon dy shtete kontraktuese të lidhin marrëveshje që aplikimet për zbatueshmërinë mund të bëhen gjithashtu edhe drejtpërdrejt midis palëve të interesuara.

Neni 19

Urdhri për kostot dhe shpenzimet do të bëhet i zbatueshëm pa asnjë seancë dëgjimore, por mund të jetë objekt i apelimit të mëtejshëm të palës humbëse në përputhje me legjislacionin e vendit ku është kërkuar zbatueshmëria.

Autoriteti kompetent për të vendosur mbi kërkesën për detyrimin e zbatueshmërisë, duhet të shqyrtojë nga ana e tij, nëse:

1) sipas ligjit të vendit ku është dhënë vendimi, kopja e vendimit përmbush kushtet e kërkuara për vërtetësinë e tij;

2) sipas të njëjtit ligj, vendimi ka forcën e *res judicata*;

3) ajo pjesë e gjykimit që përbën vendimin është përpiluar në gjuhën e autoritetit, të cilit i drejtohet kërkesa ose në gjuhën e rënë dakord midis dy shteteve të interesuara, ose nëse është shoqëruar me një përkthim në njërën prej atyre gjuhëve dhe, përveçse në rastet kur ka një marrëveshje kundërshtuese, ajo të jetë e certifikuar nga një zyrtar diplomatik ose një agjent konsullor të shtetit që ka bërë kërkesën ose nga një përkthyes i licencuar i shtetit të cilit i drejtohet kërkesa.

Për të përmbushur kushtet e përshkruara në paragrafin e dytë, nënparagrafët 1 dhe 2, është e mjaftueshme ose duke pasur një deklaratë nga ana e autoritetit kompetent të shtetit të origjinës që përcakton se vendimi ka fuqinë e *res judicata*, ose duke paraqitur dokumentet e duhura të legalizuara që tregojnë se vendimi ka fuqinë e *res judicata*. Kompetenca e autoritetit të përmendur më sipër, përveçse në rastet kur ka një marrëveshje kundërshtuese, duhet të certifikohet nga zyrtari më i lartë në detyrë i administratës së drejtësisë të shtetit të origjinës që ka bërë kërkesën. Deklarata dhe certifikata e përmendur më sipër duhet të përpilohen apo përkthehen në përputhje me rregullin e përshkruar në paragrafin e dytë, nënparagrafi 3.

Autoriteti kompetent për të vendosur në lidhje me kërkesën e detyrimit të zbatueshmërisë, duhet të vlerësojë nëse pala e interesuar kërkon një gjë të tillë në të njëjtën kohë, sasinë e shpenzimeve të vërtetimit, përkthimit dhe legalizimit që i referohen nënparagrafit 3 të paragrafit të dytë. Kjo kosto do të konsiderohet si kosto dhe shpenzime të procedimeve.

IV. ASISTENCA LIGJORE FALAS

Neni 20

Në çështjet civile dhe tregtare, shtetasve të shteteve kontraktuese do t'u jepet asistencë ligjore falas në të gjitha shtetet e tjera kontraktuese, mbi të njëjtat baza si shtetas të këtyre shteteve, në përputhje me legjislacionin e shtetit ku kërkohet kjo asistencë ligjore falas.

Në shtetet ku asistenca ligjore jepet për çështje administrative, dispozitat e paragrafit të mësipërm do të zbatohen gjithashtu edhe për çështjet gjyqësore që çohen në gjykatat kompetente për çështje të tilla.

Neni 21

Në të gjitha rastet, certifikata ose deklarata e kërkesës duhet të lëshohet, ose merret nga autoritetet e vendbanimit të përhershëm të personit të huaj, ose nëse jo prej tyre, nga ana e autoriteteve të vendbanimit aktual të tij. Nëse këto autoritete të fundit nuk i përkasin një shteti kontraktues dhe nuk lëshojnë ose marrin deklarata apo certifikata të këtij lloji, është e mjaftueshme të lëshohet një certifikatë ose deklaratë e dhënë apo marrë nga një zyrtar diplomatik, ose agjent konsullor i vendit të cilit personi i huaj i përket.

Nëse personi që bën kërkesën nuk banon në vendin nga është bërë kërkesa, certifikata ose deklarata e kërkesës legalizohet pa pagesë nga një zyrtar diplomatik ose agjent konsullor i vendit ku përgatitet ky dokument.

Neni 22

Autoriteti kompetent për lëshimin e certifikatës ose marrjen e deklaratës së kërkesës mund të sigurojë informacion në lidhje me gjendjen financiare të personit që bën kërkesën, nga autoritetet e shteteve të tjera kontraktuese.

Autoriteti përgjegjës për të vendosur në aplikimet për asistencë ligjore falas duhet të ketë të drejtën, brenda kufijve të autoritetit të tij, të verifikojë certifikatat, deklaratat dhe informacionin e dhënë atij, si dhe të kërkojë për verifikim dhe informacion të mëtejshëm.

Neni 23

Kur personi i interesuar, me të ardhura tepër të kufizuara, është në një vend të ndryshëm nga ai ku kërkohet asistencë ligjore falas, aplikimi i tij për asistencë ligjore falas, i shoqëruar me certifikatat, deklaratat e kërkesës dhe, aty ku është e nevojshme, edhe dokumente të tjera ndihmëse që mund të lehtësojnë shqyrtimin e aplikimit, mund të transmetohen nga konsulli i vendit të tij për autoritetin kompetent vendimmarrës për atë aplikim ose për autoritetin e caktuar nga shteti ku do të shqyrtohet aplikimi.

Për transmetimin e aplikimeve për asistencë ligjore falas, do të respektohen dispozitat në nenin 9, paragrafët 2, 3 dhe 4, dhe në nenet 10 dhe 12 më sipër, që kanë të bëjnë me letrat e kërkesës, si dhe shtojcat e tyre.

Neni 24

Nëse një shtetasi të një prej shteteve kontraktuese i është dhënë përfitim i asistencës ligjore, dërgimi i dokumenteve që kanë të bëjnë me rastin e tij në një shtet tjetër kontraktues, pavarësisht metodës që ky dërgim do të kryhet, nuk do të shkaktojë rimbursime të shpenzimeve nga shteti i origjinës për shtetin të cilit i drejtohet kërkesa.

E njëjta gjë respektohet edhe për letrat e kërkesës, me përjashtim të tarifave që paguhen për ekspertët.

V. LËSHIM FALAS I DOKUMENTEVE NGA REGJISTRI I GJENDJES CIVILE

Neni 25

Personat e varfër që janë shtetas të një prej shteteve kontraktuese mund të marrin pa pagesë me të njëjtat kushte si shtetasit e shtetit të interesuar, dokumente nga regjistri i gjendjes civile. Dokumentet e nevojshme për martesat e tyre duhet të legalizohen pa pagesë nga ana e zyrtarit diplomatik ose agjentit konsullor të shteteve kontraktuese.

KAPITULLI VI NDALIMI FIZIK

Neni 26

Ndalimi fizik, qoftë si mjet zbatimi ose thjesht si një masë e përkohshme, nuk do të përdoret në fushën civile dhe tregtare ndaj të huajve që janë shtetas të njëjës prej palëve kontraktuese në rrethanat kur nuk do të mund të përdorej ndaj shtetasve të vetë atij shteti. Një fakt që mund të përdoret nga një shtetas me banim në këtë vend për t'i shpëtuar ndalimit fizik, mund të përdoret me të njëjtin efekt nga shtetas i një pale kontraktuese, edhe nëse ai fakt ka ndodhur jashtë vendit.

KAPITULLI VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27

Kjo konventë është e hapur për t'u firmosur nga shtetet anëtare të përfaqësuara gjatë sesionit të shtatë të Konferencës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Kjo konventë do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Çdo instrument ratifikimi që do të depozitohet, do të regjistrohet dhe një kopje e vërtetuar e këtij regjistrimi do t'i përcillet çdo shteti nënshkrues përmes kanaleve diplomatike.

Neni 28

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të katërt të ratifikimit siç parashikohet në paragrafin e dytë të nenit 27.

Konventa do të hyjë në fuqi për çdo shtet palë që e ratifikon atë në një datë të mëvonshme në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit përkatës të ratifikimit.

Neni 29

Kjo Konventë do të zëvendësojë, në lidhje me shtetet që e kanë ratifikuar atë, Konventën mbi Procedurën Civile të nënshkruar në Hagë, më 17 korrik 1905.

Neni 30

Kjo Konventë do të zbatohet ligjërisht në territoret metropolitane të palëve kontraktuese.

Çdo shtet mund të deklarojë që kjo Konventë do të shtrihet në të gjithë territorin ose në një ose më shumë njësi territoriale të tij për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ai është përgjegjës, përmes një dokumenti me shkrim që do të depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta. Ministria e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta do t'i përcjellë një kopje të vërtetuar të këtij dokumenti çdo shteti nënshkrues përmes kanaleve diplomatike.

Konventa do të hyjë në fuqi ndërmjet shteteve të cilët nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim për këtë aderim brenda gjashtëdhjetë ditëve pas këtij komunikimi dhe territorit ose territoreve për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve shteti në fjalë është përgjegjës dhe në lidhje me të cilin është bërë komunikimi i mësipërm.

Neni 31

Çdo shtet që nuk është përfaqësuar gjatë sesionit të shtatë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private mund të aderojë në këtë Konventë, nëse asnjë nga shtetet të cilat e kanë ratifikuar atë nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim në lidhje me këtë aderim brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit prej Qeverisë së Vendeve të Ulëta për këtë aderim. Aderimi do të kryhet sipas mënyrës së parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 27.

Shtetet të cilat e kanë ratifikuar atë, nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim në lidhje me këtë aderim brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit prej Qeverisë së Vendeve të Ulëta për këtë aderim. Aderimi do të kryhet sipas mënyrës së parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 27.

Një aderim i tillë nuk do të mund të kryhet deri pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenin 28, paragrafi i parë.

Neni 32

Çdo palë kontraktuese, gjatë firmosjes dhe ratifikimit të kësaj Konvente apo aderimit në të, mund të rezervojë të drejtën të kufizojë zbatimin e nenit 17 te shtetasit e palëve kontraktuese që kanë vendbanimin e përhershëm në territorin e tij.

Çdo shtet që shfrytëzon të drejtën e përmendur në paragrafin më sipër do të jetë në gjendje të pretendojë zbatimin e nenit 17 nga palët kontraktuese vetëm në emër të shtetasve të vet, të cilët kanë vendbanimin e përhershëm në territorin e palës tjetër kontraktuese përpara gjykatës së të cilës ata janë palë kërkuuese ose palë të treta.

Neni 33

Kjo Konvente do të mbetet në fuqi për një periudhë 5-vjeçare nga dita e treguar në paragrafin e parë të nenit 28 të Konventës.

Kjo periudhë do të fillojë që nga ajo ditë edhe për shtetet që e kanë ratifikuar ose kanë aderuar në të në një datë të mëvonshme.

Në rast se nuk ka pasur asnjë denoncim, Konventa do të rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet. Çdo denoncim duhet t'i njoftohet të paktën 6 muaj përpara mbarimit të periudhës pesëvjeçare pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta, e cila do të informojë shtetet e tjera palë për këtë denoncim.

Denoncimi mund të jetë i kufizuar në një territor ose territore të caktuara në të cilat zbatohet Konventa, përmes një njoftimi të dhënë në përputhje me nenin 30, paragrafi i dytë.

Denoncimi do të ketë efekt vetëm përsa i përket shtetit i cili e ka bërë atë. Konventa do të qëndrojë në fuqi për shtetet e tjera palë.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht, nënshkruajnë këtë Konventë.

Bërë në Hagë më 1 mars 1954, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Qeverisë së Vendeve të Ulëta, prej së cilës një kopje e vërtetuar i dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike çdo shteti të përfaqësuar në sesionin e shtatë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

LIGJ

Nr.10 183, datë 29.10.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.9374, DATË 21.4.2005 “PËR NDIHMËN SHTETËRORE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

Neni 1

Neni 2 “Fusha e zbatimit” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për veprimtaritë, që ushtrohen në të gjithë sektorët e prodhimit dhe të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të sektorëve të bujqësisë e të peshkimit.”.

Neni 2

Në nenin 3 “Përkufizime”, pas pikës 14 shtohen pikat 15 e 16 me këtë përmbajtje:

“15. “Ndihma për riskun e kapitalit” është financimi që u bëhet ndërmarrjeve, nëpërmjet pjesëmarrjes në kapital në formën e kuotave, të aksioneve ose obligacioneve të konvertueshme në aksione, në fazat e para të rritjes/themelimit dhe administrimit të tyre.

16. “Ndihma për mbrojtjen e mjedisit” është çdo veprim i ndërmarrë për të rregulluar apo parandaluar dëmet, që u shkaktohen mjedisit fizik ose burimeve natyrore nga veprimtaria e përfutjesit të ndihmës, në mënyrë që të pakësohet shkalla e rrezikut, i cili vjen prej dëmit, ose të sigurohet përdorimi sa më eficient i burimeve natyrore.”.

Neni 3

Në fund të nenit 5 “Ndihma për eksport”, pas fjalëve “veprimtarinë e eksportit.” shtohen fjalët “, si dhe ndihma, që kushtëzohet me përdorimin e produkteve vendase kundrejt produkteve të importuara.”.

Neni 4

Neni 8 “Ndihma “De minimis”” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8 Ndihma “De minimis”

Ndihma është e lejueshme nëse ajo, pavarësisht formës ose qëllimit për të cilin jepet, nuk kalon vlerën 100 000 euro, për një periudhë financiare prej tre vjetësh dhe, në të njëjtën kohë, nuk jepet për veprimtaritë e eksportit, nuk kushtëzohet me përdorimin e produkteve vendase kundrejt produkteve të importuara dhe përfituesi nuk është një ndërmarrje në vështirësi.”.

Neni 5

Në nenin 9 “Ndihma për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli ndryshohet dhe bëhet “Ndihma në formën e shërbimeve këshillimore dhe për pjesëmarrjen në panairë për ndërmarrjet e vogla e të mesme”.
2. Shkronja “a” shfuqizohet.

Neni 6

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 9/1 Ndihma për ndërmarrjet e vogla të sapokrijuara

Ndihma për ndërmarrjet e vogla të sapokrijuara, të cilat janë regjistruar për herë të parë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit gjatë 12 muajve të fundit, lejohet nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

- a) vlera e ndihmës nuk kalon masën 200 000 euro;
- b) vlera vjetore nuk duhet të kalojë 33 për qind të vlerës së ndihmës së parashikuar në shkronjën “a” të këtij neni;
- c) intensiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë 40 për qind të kostove të pranueshme për 3 vitet e para pas krijimit të ndërmarrjes dhe 30 për qind në dy vitet pasardhëse;
- ç) kostot e pranueshme do të jenë kostot administrative, ligjore dhe këshillimore, që lidhen drejtpërdrejt me krijimin e ndërmarrjeve të vogla, si dhe kostot operacionale për 5 vitet e para pas krijimit të ndërmarrjes. TVSH-ja dhe tatimi mbi të ardhurat e biznesit nuk përfshihen në kostot e pranueshme;
- d) ndërmarrjet e vogla, të kontrolluara nga aksionarë të ndërmarrjeve, që janë mbyllur gjatë 12 muajve të mëparshëm, nuk mund të përfitojnë ndihmë, në rast se ndërmarrjet e lartpërmendura janë aktive në tregun përkatës apo në tregje të lidhura me të.”.

Neni 7

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Ndihma për punonjësit në vështirësi dhe me aftësi të kufizuar

Ndihma për punonjësit në vështirësi dhe për punonjësit me aftësi të kufizuar lejohet nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) intensiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë 75 për qind të kostove të pagave për punonjësit me aftësi të kufizuara dhe 50 për qind të kostove të pagave për punonjësit në vështirësi;

b) kostot e pranueshme janë kostot mesatare për një periudhë jo më shumë se 12 muaj, nga çasti i marrjes në punë të një punonjësi në vështirësi dhe për çdo periudhë të caktuar, që është marrë në punë një punonjës me aftësi të kufizuar;

c) intensiteti i ndihmës për kompensimin e kostove shtesë për punonjësit me aftësi të kufizuar nuk kalon masën 100 për qind të kostove të pranueshme.”.

Neni 8

Në nenin 11 “Ndihma për trajnim” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “a”, numri “35” bëhet “45”.

2. Në shkronjën “b”, numri “50” bëhet “60” dhe numri “70” bëhet “80”.

Neni 9

Pas nenit 13 shtohen nenet 13/1 dhe 13/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 13/1

Ndihma për mbrojtjen e mjedisit

Ndihma për mbrojtjen e mjedisit mund të jepet vetëm për:

a) investim për nxitjen e energjisë nga burime të rinovueshme të energjisë dhe intensiteti i saj nuk kalon 45 për qind të kostove të pranueshme. Kostot e pranueshme janë kostot shtesë, që prodhon/mbart përfituesi, krahasuar me një impiant konvencional me kapacitet të njëjtë. Intensiteti i ndihmës rritet me 20 për qind për ndërmarrjet e vogla dhe me 10 për qind për ndërmarrjet e mesme;

b) investim për menaxhimin e humbjeve të ndërmarrjeve të tjera, përfshirë këtu ripërdorimin, riciklimin dhe kthimin dhe intensiteti nuk kalon 50 për qind të kostove të pranueshme. Kostot e pranueshme janë kostot shtesë, që prodhon/mbart përfituesi, krahasuar me një prodhim konvencional me kapacitet të njëjtë, por që nuk përfshin menaxhimin e humbjeve. Intensiteti i ndihmës rritet me 20 për qind për ndërmarrjet e vogla dhe me 10 për qind për ndërmarrjet e mesme;

c) investim për ndërmarrjet, që merren me riparimin e dëmeve mjedisore, duke rehabilituar zonat e ndotura, në qoftë se ndërmarrja që ka shkaktuar ndotjen nuk është identifikuar dhe intensiteti i ndihmës mund të arrijë deri në 100 për qind të kostove të pranueshme. Kostot e pranueshme janë kostot për punën rregulluese, duke i zbritur rritjen e çmimit të tokës;

ç) investim për prodhimin e kombinuar e me efikasitet të lartë të energjisë dhe nxehtësisë, në qoftë se intensiteti nuk kalon 45 për qind të kostove të pranueshme. Kostot e pranueshme janë kostot shtesë, që prodhon/mbart përfituesi, krahasuar me një investim referencë. Intensiteti i ndihmës rritet me 20 për qind për ndërmarrjet e vogla dhe me 10 për qind për ndërmarrjet e mesme.

Neni 13/2

Ndihma në formën e riskut të kapitalit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Skemat e ndihmës në formën e riskut të kapitalit për ndërmarrjet e vogla e të mesme lejohen vetëm nëse:

a) masa e ndihmës ka formën e pjesëmarrjes në një fond fitimprurës privat investimesh, të menaxhuar në kushtet e tregut;

b) këstet, që u jepen ndërmarrjeve përfituese nga fondi i investimit gjatë një periudhe prej 12 muajsh, nuk duhet të kalojnë vlerën 200 000 euro;

c) risku i kapitalit kufizohet vetëm në ofrimin e kapitalit bazë, kapitalit themeltar dhe/ose për zgjerimin e kapitalit;

ç) nga fondi i investimit investohet në ndërmarrjet e vogla e të mesme përfituese në formën e kuotave, të aksioneve ose obligacioneve të konvertueshme në aksione, të paktën 70 për qind e buxhetit të tij të përgjithshëm;

d) investitorët privatë mbulojnë jo më pak se 25 për qind të financimit të fondit të investimeve.”.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.6342, datë 17.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 184, datë 29.10.2009

**PËR FALJEN E KAMATËVONESAVE TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE TË
DETYRUESHME SHOQËRORE, TË PAPAGUARA, TË TË VETËPUNËSUARVE NË
BUJQËSI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

1. Të vetëpunësuarve në bujqësi u falen kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, të papaguara, me kusht që detyrimet e këtyre kontributeve të arkëtohen brenda datës 31.3.2010.

2. Kamatëvonesat e papaguara falen edhe kur kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 2

Kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kthehen.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.6343, datë 17.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 187, datë 12.11.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES PËR THJESHTIMIN E PROCEDURAVE TË VIZAVE PËR SHOHERËT PROFESIONISTË TË KAMIONËVE, SHTETAS TË VENDEVE ANËTARE TË ORGANIZATËS PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK TË DETIT TË ZI”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja për thjeshtimin e procedurave të vizave për shoherët profesionistë të kamionëve, shtetas të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6348, datë 24.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
PËR THJESHTIMIN E PROCEDURAVE TË VIZAVE PËR SHOHERËT PROFESIONISTË TË KAMIONËVE, SHTETAS TË VENDEVE ANËTARE TË ORGANIZATËS PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK TË DETIT TË ZI

Qeveritë e mëposhtme nënshkruese (të referuara më poshtë si palët kontraktuese), në cilësinë e qeverive të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi;

duke marrë parasysh nenin 6 të “Memorandumit të mirëkuptimit për lehtësimin e transportit rrugor të mallrave në rajonin e Organizatës për Bashkëpunim të Detit të Zi”, të nënshkruar në Kiev më 6 mars 2002, në veçanti paragrafin 2 të tij;

duke qenë të bindura se thjeshtimi i procedurave të vizave për shoherët profesionistë të kamionëve, shtetas të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të angazhuar në transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave në rajonin e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, do të përshpejtojë zhvillimin e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike ndërmjet vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Secila palë kontraktuese, nëpërmjet autoriteteve kompetente kombëtare të caktuara për këtë qëllim, mund të hartojë, veçmas për çdo palë kontraktuese, listën kombëtare të shoherëve profesionistë, shtetas të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi të angazhuar në transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave në territorin e palës kontraktuese respektive.

2. Lista kombëtare e shoferëve profesionistë duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme për çdo shofer:

- emri i plotë;
- data dhe vendi i lindjes;
- emri i shoqërisë;
- numri i pasaportës dhe vlefshmëria e saj;
- numri i patentës së shoferit , data e lëshimit dhe/ose e skadimit.

3) Palët kontraktuese të cilat do të hartojnë listën kombëtare të shoferëve profesionistë të parashikuar në nenin 1, paragrafi 1, duhet t'ua komunikojnë ato nëpërmjet kanaleve diplomatike BSEC PERMIS. Kjo e fundit duhet të hartojë listën e konsoliduar të listave kombëtare që do t'u dërgohet ministrive të punëve të jashtme të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi. Lista e konsoliduar e marrë nga ministritë e punëve të jashtme të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, do t'u dërgohet autoriteteve kombëtare kompetente për lëshimin e vizave. Pas marrjes së listës së konsoliduar të shoferëve profesionistë, autoritetet e lëshimit të vizave të Palëve Kontraktuese, në parim, nuk do të kërkojnë dokumente shtesë që pyesin mbi statusin e shoferit.

Neni 2

1. Misionet diplomatike dhe konsullore të palëve kontraktuese do të lëshojnë viza për aplikuesit, shoferët profesionistë, shtetas të palëve kontraktuese të angazhuar në transportin ndërkombëtar rrugor në rajonin e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

2. Misionet diplomatike dhe konsullore të palëve kontraktuese mund të kërkojnë informacion shtesë për dokumentacionin që lidhet me lëshimin e vizës.

3. Vizat me shumë hyrje do të jenë të vlefshme për një periudhë maksimale prej 1(një) viti, duke marrë parasysh periudhën e vlefshmërisë së patentës së shoferit. Palët kontraktuese do të bëjnë të gjitha përpjekjet për përsheptimin e dhënies së vizave në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar. Kohëzgjatja maksimale e qëndrimit për çdo hyrje do të përcaktohet në përputhje me legjislacionin kombëtar të çdo pale kontraktuese.

Neni 3

Autoritetet kompetente, në bazë të legjislacionit kombëtar, do t'i zgjasin vizat apo autorizimet e qëndrimit që u lëshohen shoferëve profesionistë, shtetas të palëve kontraktuese të angazhuar në transportin rrugor ndërkombëtar në rajonin e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të cilët gjatë kalimit tranzit janë në territorin e njëres prej palëve kontraktuese pas skadimit të periudhës së vlefshmërisë së vizës së tyre për shkak të veprimit të forcave madhore.

Neni 4

Asnjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk do të cenojë zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të zbatueshme dypalëshe apo shumëpalëshe, detyruese për çdo palë kontraktuese, apo zbatimin e rregulloreve dhe ligjeve kombëtare për lëshimin e vizave të hyrjes, qëndrimin e përkohshëm apo dëbimin e shtetasve të huaj në secilin prej vendeve respektive.

Neni 5

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi apo zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet miqësisht nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve mes palëve kontraktuese.

Neni 6

1. Çdo palë kontraktuese mund të propozojë amendamente të kësaj Marrëveshjeje. Amendamenti i propozuar do t'i dorëzohet depozitarit, i cili do ta qarkullojë atë menjëherë te të gjitha palët kontraktuese.

2. Amendamenti do të hyjë në fuqi për çdo palë kontraktuese që depoziton instrumentin e ratifikimit, pranimin apo miratimin të amendamentit përkatës 30 ditë pas datës në të cilën më shumë se katër palë kontraktuese kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimin apo miratimin të amendamentit përkatës pranë depozitarit. Pas kësaj, amendamenti do të hyjë në fuqi për çdo palë tjetër kontraktuese në datën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimin apo miratimit të amendamentit përkatës pranë depozitarit.

Neni 7

1. Çdo palë kontraktuese, për arsye të sigurisë kombëtare, rendit publik apo shëndetit publik, mund të vonojë hyrjen në fuqi apo të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje tërësisht apo pjesërisht në drejtim të të gjithave apo disave prej palëve kontraktuese. Vendosja dhe heqja e një mase të tillë duhet t'i komunikohet menjëherë BSEC PERMIS nëpërmjet kanaleve diplomatike, të cilat, si rregull, duhet të njoftojnë të gjitha palët kontraktuese.

2. Një palë kontraktuese, e cila zgjedh të ushtrojë njërën prej masave të renditura në nenin 7 paragrafi 1, mund të mos kërkojë zbatimin e vazhdueshëm të kësaj Marrëveshjeje ndaj shtetasve të saj nga pala kontraktuese kundër shtetasve të së cilës janë marrë masat në fjalë.

Neni 8

1. Kjo Marrëveshje do të hapet për nënshkrim nga qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të cilat mund të bëhen palë në Marrëveshje, në përputhje me procedurat e tyre të brendshme përkatëse nëpërmjet:

- i) nënshkrimit pa rezerva të ratifikimit, pranimin apo miratimit;
- ii) nënshkrimit me rezerva të ratifikimit, pranimin apo miratimit, të ndjekur nga ratifikimi, pranimi apo miratimi.

2. Qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të cilat bëhen palë e kësaj Marrëveshjeje siç përcaktohet në nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi "i", duhet të njoftojnë BSEC PERMIS në lidhje me këtë. Në mënyrë të ngjashme, këto qeveri të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të cilat bëhen palë e kësaj Marrëveshjeje siç përcaktohet në nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi "ii", do të depozitojnë një instrument të ratifikimit, pranimin apo miratimit pranë BSEC PERMIS.

Neni 9

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas datës në të cilën më shumë se katër palë kontraktuese, në përputhje me nenin 8:

- i) kanë nënshkruar Marrëveshjen pa rezerva në drejtim të ratifikimit, pranimin apo miratimit dhe kanë njoftuar për këtë BSEC PERMIS nëpërmjet kanaleve diplomatike; ose,
- ii) kanë nënshkruar dhe ratifikuar, pranuar apo miratuar Marrëveshjen me rezerva në drejtim të ratifikimit, pranimin apo miratimit dhe kanë depozituar instrumentin e ratifikimit, pranimin apo miratimit pranë BSEC PERMIS.

2. Në rast se një nga qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi e ratifikon apo pranon këtë Marrëveshje pas hyrjes së saj në fuqi, Marrëveshja do të hyjë në fuqi më pas për palën që e miraton, tridhjetë ditë pas depozitimit nga ana e saj e instrumenteve të ratifikimit apo aderimit.

Neni 10

BSEC PERMIS do të jetë depozitari i kësaj Marrëveshjeje. Ai do t'i njoftojë menjëherë palët kontraktuese në lidhje me:

- a) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, si edhe qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të cilat e kanë nënshkruar dhe ratifikuar, pranuar, miratuar atë, apo kanë aderuar në të;
- b) çdo njoftim të marrë në përputhje me nenet 6, 7, 8, 9 dhe 11, si edhe datën e tij efektive;
- c) hyrjen në fuqi të çdo amendamenti të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar. Çdo palë kontraktuese mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje duke njoftuar për këtë qëllim BSEC PERMIS gjashtë muaj para.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit e autorizuar rregullisht për këtë, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 23 tetor 2008, në gjuhën angleze, në një kopje origjinale që do të mbetet e depozituar pranë BSEC PERMIS, e cila do t'i përcjellë një kopje të vërtetuar secilës prej palëve kontraktuese.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë

Lulzim Basha, Ministër i Punëve të Jashtme

Në emër të Qeverisë së Republikës së Armenisë:

Edward Nalbandian, Ministër i Punëve të Jashtme

Në emër të Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit

Në emër të Qeverisë së Republikës së Bullgarisë

Në emër të Qeverisë së Gjeorgjisë

Në emër të Qeverisë së Republikës Greke

Në emër të Qeverisë së Republikës së Moldavisë:

Valeriu OSTALEP, Zv. Ministër i Punëve të Jashtme dhe Integrimit Evropian

Në emër të Qeverisë së Rumanisë

Në emër të Qeverisë së Federatës Ruse

Në emër të Qeverisë së Republikës së Serbisë

Në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë:

Ali BABACAN, Ministër i Punëve të Jashtme

Në emër të Qeverisë së Ukrainës

LIGJ
Nr.10 188, datë 12.11.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES PËR THJESHTIMIN E PROCEDURAVE TË VIZAVE PËR AFARISTËT, SHTETAS TË VENDEVE ANËTARE TË ORGANIZATËS PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK TË DETIT TË ZI”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja për thjeshtimin e procedurave të vizave për afaristët, shtetas të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6349, datë 24.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
PËR THJESHTIMIN E PROCEDURAVE TË VIZAVE PËR AFARISTËT, SHTETAS TË VENDEVE ANËTARE TË ORGANIZATËS PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK TË DETIT TË ZI

Qeveritë e mëposhtme nënshkruese (të referuara më poshtë si palët kontraktuese), në cilësinë e qeverive të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi;

duke qenë të bindura se thjeshtimi i procedurave të vizave për afaristët, shtetas të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, do të përshpejtojë zhvillimin e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike ndërmjet vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi;

duke vepruar në përputhje me dispozitat universale të së drejtës ndërkombëtare dhe legjislacionit kombëtar;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Të gjitha misionet diplomatike dhe konsullore të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi do të lëshojnë/zgjasin vizat e hyrjes (hyrjeje-daljeje) për afaristët/administratorët, shtetas të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, me kusht që mbajtësi/mbajtësja e vizës të mos përfshihet në ndonjë veprimtari të papajtueshme me statusin e tij/të saj në vendin pritës.

2. Vizat për afaristët e referuar në paragrafin 1 të këtij neni do të jepen nga misionet diplomatike dhe konsullore të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi pas dorëzimit të dokumenteve përkatëse të lëshuara nga dhomat e tregtisë/industrisë apo nga autoritetet kompetente të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të parashikuara nga legjislacioni i tyre i brendshëm.

Neni 2

a) Të gjitha misionet diplomatike dhe konsullore të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi duhet të lëshojnë viza brenda tri ditëve pune ose përndryshe duhet t'i japin përgjigje aplikuesit brenda së njëjtës periudhë kohore.

b) Vizat me shumë hyrje do të lëshohen për një periudhë kohore nga një deri në pesë vjet. Kohëzgjatja maksimale e qëndrimit do të përcaktohet në përputhje me legjislacionin kombëtar të çdo vendi anëtar.

Neni 3

1. Asnjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk do të cenojë zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të zbatueshme dypalëshe apo shumëpalëshe, detyruese për çdo palë kontraktuese apo zbatimin e rregulloreve dhe ligjeve kombëtare për lëshimin e vizave të hyrjes dhe lejeve të qëndrimit të përkohshëm apo dëbimin e shtetasve të huaj në secilin prej vendeve përkatëse.

Neni 4

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi apo zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet miqësisht nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve mes palëve kontraktuese.

Neni 5

a) Çdo palë kontraktuese mund të propozojë amendamente të kësaj Marrëveshjeje. Amendamenti i propozuar do t'i dorëzohet depozitarit, i cili do ta qarkullojë atë menjëherë te të gjitha palët kontraktuese. Amendamenti duhet të jetë objekt i bisedimeve dhe pranimet nga palët kontraktuese.

b) Amendamenti do të hyjë në fuqi për çdo palë kontraktuese që depoziton instrumentin e ratifikimit apo miratimit të amendamentit përkatës 30 ditë pas datës në të cilën më shumë se katër palë kontraktuese kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit apo miratimit të amendamentit përkatës pranë depozitarit. Pas kësaj, amendamenti do të hyjë në fuqi për çdo palë tjetër kontraktuese në datën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit apo miratimit të amendamentit përkatës pranë depozitarit.

Neni 6

a) Çdo palë kontraktuese, për arsye të sigurisë kombëtare, rendit publik apo shëndetit publik, mund të vonojë hyrjen në fuqi apo të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, tërësisht apo pjesërisht, në drejtim të të gjitha apo disave prej palëve kontraktuese. Vendosja dhe heqja e një mase të tillë duhet t'i komunikohet menjëherë BSEC PERMIS nëpërmjet kanaleve diplomatike, të cilat, si rregull duhet të njoftojnë të gjitha palët kontraktuese.

b) Një palë kontraktuese, e cila zgjedh të ushtrojë njërën prej masave të renditura në nenin 6 paragrafi "a", mund të mos kërkojë zbatimin e vazhdueshëm të kësaj Marrëveshjeje ndaj shtetasve të saj nga pala kontraktuese kundër shtetasve të së cilës janë marrë masat.

Neni 7

a) Kjo Marrëveshje do të hapet për nënshkrim nga qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të cilat mund të bëhen palë në Marrëveshje, në përputhje me procedurat e tyre përkatëse nëpërmjet:

- i) nënshkrimit pa rezerva të ratifikimit apo miratimit;
- ii) nënshkrimit me rezerva të ratifikimit apo miratimit, të ndjekur nga ratifikimi apo miratimi.

b) Qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi të cilat bëhen palë të kësaj Marrëveshjeje siç përcaktohet në nenin 7 paragrafi “a” nënparagrafi “i”, duhet ta njoftojnë BSEC PERMIS në lidhje me këtë. Në mënyrë të ngjashme, këto qeveri të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të cilat bëhen palë të kësaj Marrëveshjeje siç përcaktohet në nenin 7 paragrafi “a” nënparagrafi “ii”, do të depozitojnë instrumentet e tyre të ratifikimit apo miratimit pranë BSEC PERMIS.

Neni 8

a) Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas datës në të cilën më shumë se katër palë kontraktuese, në përputhje me nenin 7:

- i) kanë nënshkruar marrëveshjen pa rezerva në drejtim të ratifikimit apo miratimit dhe kanë njoftuar për këtë BSEC PERMIS nëpërmjet kanaleve diplomatike; ose,
- ii) kanë nënshkruar dhe ratifikuar apo miratuar Marrëveshjen dhe kanë depozituar instrumentin e ratifikimit apo miratimit pranë BSEC PERMIS.

b) Në rast se një nga qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi e pranon këtë Marrëveshje pas hyrjes së saj në fuqi, Marrëveshja do të hyjë në fuqi më pas për palën që e miraton, tridhjetë ditë pas depozitimit të instrumentit të saj të aderimit.

Neni 9

BSEC PERMIS do t’i njoftojë menjëherë palët kontraktuese në lidhje me:

- a) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, si edhe qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik të Detit të Zi, të cilat e kanë nënshkruar dhe ratifikuar dhe miratuar atë, apo kanë aderuar në të;
- b) çdo njoftim të marrë në përputhje me nenet 6 ose 10, si edhe datën e tij efektive;
- c) hyrjen në fuqi të çdo amendamenti të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar. Çdo palë kontraktuese mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje duke njoftuar për këtë qëllim BSEC PERMIS gjashtë muaj para.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit e autorizuar rregullisht për këtë, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 23 tetor 2008, në gjuhën angleze, në një kopje origjinale që do të mbetet e depozituar pranë BSEC PERMIS, e cila do t’u përcjellë një kopje të vërtetuar secilës prej palëve kontraktuese.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë:

Lulzim Basha, Ministër i Punëve të Jashtme

Në emër të Qeverisë së Republikës së Armenisë:

Edward Nalbandian, Ministër i Punëve të Jashtme

Në emër të Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit

Në emër të Qeverisë së Republikës së Bullgarisë

Në emër të Qeverisë së Gjeorgjisë
Në emër të Qeverisë së Republikës Greke
Në emër të Qeverisë së Republikës së Moldavisë:
Valeriu OSTALEP, Zëvendësministër i Punëve të Jashtme dhe Integritetit Evropian
Në emër të Qeverisë së Rumanisë
Në emër të Qeverisë së Federatës Ruse
Në emër të Qeverisë së Republikës së Serbisë
Në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë:
Ali BABACAN, Ministër i Punëve të Jashtme
Në emër të Qeverisë së Ukrainës

LIGJ
Nr.10 189, datë 12.11.2009

PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT PËR IMUNITETET DHE PRIVILEGJET E ASAMBLESË PARLAMENTARE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli për imunitetet dhe privilegjet e Asamblesë Parlamentare të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6350, datë 24.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

PROTOKOLL
LIDHUR ME PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E ASAMBLESË PARLAMENTARE TË
BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI

Shtetet anëtare të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi: Republika e Shqipërisë, Republika e Armenisë, Republika e Azerbajxhanit, Republika e Bullgarisë, Gjeorgjia, Republika e Greqisë, Republika e Moldavisë, Rumania, Federata Ruse, Republika e Turqisë dhe Ukraina;

meqenëse neni 20 i Kartës së Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi parashikon se Asambleja Parlamentare e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi, si përfaqësuese e parlamenteve të shteteve anëtare, siguron mbështetje të përhershme për procesin e bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi mbi bazë konsultimesh, meqenëse APBEDZ-ja bashkëpunon ngushtë me BEDZ-in në nxitjen e objektivave të këtij të fundit, mbështetur në parimet e “Deklaratës së Samitit mbi Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi”, Stamboll, 25 qershor 1992, në vendimet e takimeve vijuese të samitit dhe “Deklaratën mbi krijimin e Asamblesë Parlamentare të Bashkëpunimit të Detit të Zi”, miratuar më 26 shkurt 1993 në Stamboll;

duke marrë parasysh rolin që mund të luajë Asambleja Parlamentare e BEDZ-it në mobilizimin e mbështetjes publike në organizimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit, në nxitjen e stabilitetit dhe paqes në rajon dhe në lehtësimin e realizimit të parimeve dhe synimeve të bashkëpunimit ekonomik të Detit të Zi;

të bindur se përfundimi i Protokollit mbi privilegjet dhe imunitetet e Asamblesë Parlamentare të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi do të lehtësojë funksionet e Asamblesë në përputhje me parimet dhe objektivat e BEDZ-it,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KREU I
PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllime të këtij protokollit:

a) “Kartë” do të thotë Karta e Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi”, bërë në Jaltë, më 5 qershor 1998.

b) “Këshilli” do të thotë Këshilli i Ministrave të Punëve të Jashtme të Organizatës së Bashkëpunimit të Detit të Zi.

c) “Shtete anëtare” do të thotë shtete që janë palë në Kartën e BEDZ-it, bërë në Jaltë, më 5 qershor 1998 dhe palë në këtë protokoll.

d) “APBEDZ” do të thotë Asambleja Parlamentare e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi.

e) “Përfaqësues të parlamenteve të shteteve anëtare” do të thotë anëtarë të delegacioneve kombëtare, të caktuar nga parlamentet e vendeve përkatëse dhe delegatë plotësues, këshilltarë, ekspertë teknikë dhe sekretarë të delegacioneve kombëtare që marrin pjesë në punimet e APBEDZ-it dhe organeve të tij.

f) “BSEC PERMIS” do të thotë Sekretariati i Përhershëm Ndërkombëtar i Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi.

g) “Stafi i Sekretariatit Ndërkombëtar” do të thotë stafi drejtues, stafi profesionist dhe stafi teknik i Sekretariatit të Përhershëm të APBEDZ-it.

h) “Prona e APBEDZ-it” do të thotë të gjitha pronat, duke përfshirë fondet dhe pasuri të tjera që u përkasin, zotërohen dhe/ose mbikëqyren nga APBEDZ-i, në përputhje me detyrat e tij zyrtare.

i) “Godina” do të thotë godina ose pjesë të tyre, duke përfshirë dhe truallin pranë tyre, që përdoren vetëm për qëllimet e APBEDZ-it, pavarësisht nga pronësia.

j) “Arkivat” do të thotë të dhënat e regjistruara, korrespondenca, dokumentet, evidencat kontabile dhe të gjitha dokumentet e tjera financiare, dorëshkrimet, piktura dhe filma me xhirim të shpejtë dhe fikse, regjistrime zanore, programe kompjuterike, materiale të shkruara, videoregjistrues ose disqe, disqe ose regjistrues me të dhëna që i përkasin ose që mbahen nga APBEDZ-i.

KREU II PRONAT

Neni 2

APBEDZ, pronat dhe pasuritë e saj, kudo që të ndodhen dhe kushdo qoftë mbajtësi i tyre, gëzojnë imunitet ndaj çdo forme procesesh ligjore, me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë, kur Këshilli, me vendim të tij, autorizon heqjen e këtij imuniteti. Sidoqoftë, ekziston mirëkuptimi se heqja e këtij imuniteti nuk do të shtrihet deri në masën e ekzekutimit ose ndalimit të pronësisë.

Neni 3

Godinat e APBEDZ-it janë të pacenueshme.

Neni 4

Arkivat e APBEDZ-it dhe në përgjithësi të gjitha dokumentet që i përkasin ose janë në zotërim të saj janë të paprekshme kudo që ndodhen.

KREU III PËRFAQËSUESIT E PARLAMENTEVE TË SHTETEVE ANËTARE

Neni 5

Përfaqësuesit e parlamenteve të shteteve anëtare, në kryerjen e funksioneve të tyre gjatë takimeve të APBEDZ-it dhe udhëtimeve të tyre për në dhe nga vendi ku zhvillohen këto takime, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e poshtëshënuara:

a) Imuniteti ndaj arrestimit ose ndalimit të personit, sekuestrimit të bagazheve vetjake dhe imuniteti ndaj proceseve ligjore të çdo lloji, lidhur me fjalët e thëna ose të shkruara dhe për të gjitha veprimet që ata kanë kryer në cilësinë e tyre si përfaqësues;

b) Paprekshmëria e të gjitha letrave dhe dokumenteve, duke përfshirë programet kompjuterike, videoregjistruesit ose disketa me të dhëna në zotërim të tyre;

c) Të drejtën për përdorimin e kodeve dhe marrjen e letrave ose korrespondencës nëpërmjet postës ose çantave me vulën e misionëve diplomatike të shteteve anëtare;

d) Përjashtimit për ta dhe bashkëshortët/bashkëshortet e tyre nga kufizimet e imigrimit, regjistrimi si të huaj ose detyrimet për shërbime kombëtare në shtetin anëtar të BEDZ-it ku ata ndodhen për vizitë ose përmes të cilit ata po kalojnë gjatë kryerjes së funksioneve të tyre;

e) Lidhur me çështjet doganore dhe kontrollit valutor:

- do t'u jepen nga qeveria e shtetit të tyre të njëjtat lehtësi si ato që u jepen zyrtarëve të lartë që udhëtojnë jashtë vendit me detyra zyrtare të përkohshme;

- do t'u jepen nga qeveritë e shteteve të tjera anëtare, të njëjtat lehtësi si ato që u jepen përfaqësuesve të qeverive të huaja që janë me detyra të përkohshme zyrtare.

Neni 6

Për t'iu garantuar përfaqësuesve të parlamenteve të shteteve anëtare lirinë e fjalës dhe pavarësinë në kryerjen e detyrave të tyre, ata do të vazhdojnë të kenë imunitet ndaj proceseve ligjore lidhur me fjalët e thëna ose të shkruara dhe për të gjitha veprimet e tjera të kryera gjatë përmbushjes

së detyrave të tyre, pavarësisht se personat në fjalë nuk janë më të angazhuar në realizimin e këtyre detyrave.

Neni 7

Privilegjet dhe imunitetet për përfaqësuesit e parlamenteve të shteteve anëtare nuk jepen për përfitime vetjake të vetë individëve, por në funksion të garantimit të kryerjes së pavarur të funksioneve të tyre në APBEDZ. Rrjedhimisht, një shtet anëtar ka të drejtë t'i heqë imunitetin përfaqësuesit të parlamentit të tij në çdo rast kur, sipas mendimit të këtij shteti anëtar, imuniteti pengon procedimin nga drejtësia dhe kur ky imunitet mund të hiqet pa cenuar qëllimin për të cilin ai është dhënë.

Neni 8

Dispozitat e neneve 5, 6 dhe 7 nuk do të aplikohen në marrëdhëniet ndërmjet përfaqësuesit të parlamentit të një shteti anëtar dhe atij shteti.

KREU IV STAFI I SEKRETARIATIT NDËRKOMBËTAR

Neni 9

Dispozitat e neneve 5, 6, 7 dhe 8 do të aplikohen për stafin e Sekretariatit Ndërkombëtar, gjatë kohës kur ata kryejnë funksionet e tyre gjatë takimeve të APBEDZ-it, si dhe udhëtimeve të tyre për në dhe nga vendet ku zhvillohen këto takime.

KREU V ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 10

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet shteteve anëtare lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij protokoll do të jenë objekt konsultimesh dhe kur nuk arrihet asnjë marrëveshje, atëherë palët e interesuara do t'ia paraqesin këtë mosmarrëveshje Këshillit për shqyrtim dhe për veprime të duhura në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

KREU VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 11

Në përputhje me nenin 20 të Kartës, asgjë në këtë protokoll nuk do të interpretohet, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, se do të ndryshojë statusin e APBEDZ-it, si një organizëm që ka lidhje me BEDZ-in.

Neni 12

1. Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet anëtare të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi.

2. Ky protokoll do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit.

3. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit do të depozitohen në Sekretariatin e Përhershëm të BEDZ-it.

Neni 13

Asnjë rezervë nuk mund të bëhet ndaj këtij protokollit, me përjashtim të dispozitave të neneve 8 dhe 9.

Neni 14

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas datës kur nëntë shtetet nënshkruese do të depozitojnë instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimi ose miratimit.

2. Për secilin shtet që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë protokoll pas datës së hyrjes së tij në fuqi, ky protokoll do të hyjë në fuqi në datën kur ai Shtet do të depozitojë instrumentet përkatëse të aderimit.

Neni 15

1. Çdo shtet anëtar mund të bëjë propozime për ndryshime ndaj këtij protokollit.

2. Teksti i çdo lloji ndryshimi të propozuar do të qarkullojë në shtetet anëtare të Organizatës nëpërmjet Sekretariatit të Përhershëm të BEDZ-it dhe do t'i paraqitet Këshillit për shqyrtim dhe miratim.

3. Ndryshimet në këtë protokoll, të miratuara sipas paragrafit 2 të sipërpërmendur, do të jenë objekt i ratifikimit, pranimi ose miratimit nga shtetet anëtare dhe do të hyjnë në fuqi sipas procedurës së parashikuar në nenin 14.

Neni 16

Kopja e vetme e origjinalit të këtij protokollit do të depozitohet te depozituesi.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit duke qenë të autorizuar sipas rregullit për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Baku, në ditën e tridhjetë e një të tetorit të vitit dy mijë e tre.

Për Republikën e Shqipërisë

Për Republikën e Armenisë

Për Republikën e Azerbajxhanit

Për Republikën e Bullgarisë

Për Gjeorgjinë

Për Republikën e Greqisë

Për Republikën e Moldavisë

Për Rumaninë

Për Federatën Ruse

Për Republikën e Turqisë

Për Ukrainën

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 4.12.2009
 Doli nga shtypi më 7.12.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2009

Çmimi 44 lekë